



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
në “ADMINISTRIM BIZNESI ”
“Kolegji Universitar Qiriazi”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Dr Etleva Leskaj

PhD. Elena Kokthi

Tetor /2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Qiriazi" (më tej KUQ), është një institucion privat i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Në vitin akademik 2016-2017 institucioni riorganizohet me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 92, datë 01.03.2017 nga Shkollë e Lartë Universitare Private "Sevasti & Parashqevi Qiriazi" në Kolegji Universitar "Qiriazi".

Kolegji Universitar "Qiriazi" është organizuar në tre njësi kryesore 2 Fakultete dhe Kolegji i lartë profesional "Qiriazi":

1. **Fakulteti i Ekonomisë** që ofron programet e studimit:

- i. në ciklin e parë: Bsc në "Menaxhim Biznesi"; Bsc në "Drejtues Finance";
- ii. në ciklin e dytë: **MP në "Administrim Biznesi"**; MP në "Financë";
Msc në "Administrim Biznesi"; Msc në "Financë".

2. **Fakulteti i Drejtësisë** ofron programet e studimit:

- i. në ciklin e parë: Bsc në "E Drejtë Biznesi"
- ii. në ciklin e dytë: MP në "E Drejtë Civile dhe Tregëtare";
Msc në "E drejtë Civile dhe Tregëtare".

3. Kolegji Profesional i Lartë "Qiriazi" me dy programe 2 vjeçare të studimit:

- i. "Teknologji Ushqimore" dhe
- ii. "Teknologji Informacioni"

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit MP në "Administrim Biznesi".

Programi MP në "Administrim Biznesi" është licencuar me VKM nr. 354, datë 12.05.2010, si program i studimit të ciklit të tretë, Master i Nivelit të Dytë (MND) në "Administrim Biznesi", me kohëzgjatje 1 vit akademik dhe 60 kredite. Leja për ushtrimin e veprimtarisë është dhënë me Urdhër të MASH nr 476, datë 28.09.2011, si program i Ciklit të dytë MP me kohëzgjatje 1.5 vite akademike dhe 90 ECTS. Ky program që nga viti 2016 ka funksionuar si MP me 60 kredite. Me shkresë nr. 8181/1 Prot, datë 04.10.2018 të MASH sqarohet që Akreditimi duhet të vazhdojë si program Master Profesional në "Administrim Biznesi", me kohëzgjatje 1 vit dhe 60 kredite.

Pranimi i studentëve që ndjekin këtë program studimi të ofruar nga Departamenti i Menaxhim Biznesit pranë KUQ është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i KUQ dhe Rregullorja e programit.

Stafi i angazhuar në këtë program studimi është i përkushtuar dhe posedon eksperiencën e nevojshme për të ofruar një shërbim cilësor. Megjithatë GVJ konstaton se programi i studimit ka nevojë për përmirësime të mëtejshme sidomos sa i përket moduleve karakterizuese që lidhen direkt me emërtimin e programit të studimit. Më konkretisht GVJ rekomandon futjen e lëndëve të menaxhimit, si menaxhimi i burimeve njërzore, menaxhimi i cilësisë etj, si një nevojë për ta përshtatur programin e studimit me titullin e lëshuar.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit **Master Profesional** në "Administrim Biznesi" të ofruar nga Departamenti i Menaxhim Biznesi pranë KUQ, filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në Kolegjin Universitar Qiriazi u realizua gjatë datave 3-4/07/2019, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me: Përgjegjësin e Departamentit dhe Dekanin e FE, me Zyrën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me Zyrën e Komisionit për Kërkimin Shkencor me Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, me Zyrën e Pranimeve dhe Këshillimit të Karrierës, me Zyrën e Burimeve Njerëzore, grupin e vlerësimit të brendshëm, pedagogët, etj.

Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Më datë 18.10.2019, përmes sistemit AMS, KUQ është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm të programit të studimit *Master Profesional në "Administrim Biznesi"*. Më datë 21.10.2019, KUQ përcjell përmes sistemit AMS përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 268 Prot., datë 21.10.2019, "*Dërgim mendimesh*". Në këtë dokument institucioni ka bërë disa komente për Draft-RVJ.

GVJ, pasi u njoh me komentet e IAL mbi draft-Raportin e hartuar prej tij, sqaron komentet si më poshtë:

Komenti i institucionit: *Në pesë standartet që ka kjo fushë, nga GVJ, tri standarte janë vlerësuar "Përbushen plotësisht" dhe dy janë vlerësuar "Përbushen pjesërisht", ndërsa fusha është vlerësuar përbushen pjesërisht. Mendojmë se vetëm nisur nga ky fakt duhet riparë vlerësimi i fushës.*

Argumentimi i GVJ: Mendojmë që ka një pasaktësi sa i përket informacionit që ka IAL për vlerësimin e kriterëve. Në RVJ standardet janë vlerësuar si vijon: standardi 1.1, standardi 1.2 dhe standardi 1.4 janë vlerësuar me '*përbushen kryesisht*' dhe jo *përbushen plotësisht*. Ndërsa dy standardet e tjera janë vlerësuar *përbushen pjesërisht*. GVJ e kupton gjykimin e institucionit që nga vlerësimi i 3 standardeve kryesisht dhe 2 standardeve pjesërisht, fusha të vlerësohej në tërësi me kryesisht, por GVJ është mbështetur në dy argumenta në dhënien e vlerësimit përbushet pjesërisht:

Së pari është bazuar në numrin e kriterëve që ka secili standard. Dy standardet që kanë vlerësimin pjesërisht (Standardet 1.3 dhe 1.5) kanë në total 14 kriterë ndërkohë që standardet që janë vlerësuar me përbushet kryesisht (Standardet 1.1, 1.2 dhe 1.4) kanë në total 12 kriterë.

Së dyti rëndësia që kanë standardet 1.3 dhe 1.5 në cilësinë e programit të studimit dhe në lidhjen e faktuar me botën e biznesit.

Për sa më sipër komenti i institucionit për rishikimin e vlerësimit për këtë standard nuk pranohet.

Komenti i Institucionit: *Standarti 1.5, kriteri 2, 3, 4 thuhet se "GVJ rekomandon që për secilin institucion në varësi të rëndësisë dhe frekuencës së bashkëpunimit, IAL të pajiset me marrëveshje të shkruara midis palëve". Të gjitha aktmarrëveshjet janë nënshkruar midis dy palëve prandaj rekomandimi nuk del i qartë.*

Argumentimi i GVJ: GVJ ka paraqitur si rekomandim për IAL pajisjen me marrëveshje të shkruara, kjo do të thotë që për secilën nga marrëveshjet institucioni të paraqesë në mënyrë nominale marrëveshjet e nënshkruara nga palët. Në dokumentacionin e paraqitur nuk kuptohet kjo gjë.

Komenti i Institucionit: *Standarti 1.5, kriteri 5 thuhet se "Programi MP AB është hapur në vitin akademik 2017/2018" Në RVB, për master Profesional "Administrim Biznesi" tek kreu "1.1 Përmbledhje është shënuar se me Urdhër të MASH Nr 476 dt 28.09.2011, ndër të tjera është miratuar edhe ky program.*

Argumentimi i GVJ: GVJ mendon që komenti nuk ndikon në vlerësimin e kriterit.

Komenti i Institucionit: *Në kriteret 3-4, sugjerohen lëndët, Menaxhim Operacionesh, Spërmarrje, Menaxhim i burimeve njerëzore, Sjellje Organizative, Menaxhim Strategjik. Shënojme se në ciklin e parë të studimeve, "Menaxhim Biznesi" janë zhvilluar lëndët Menaxhim Operacionesh, Menaxhim i burimeve njerëzore, Menaxhim Strategjik dhe Ekonomiks i Punës. Gjithashtu, ndër të tjera në programin e studimit MPAB zhvillohen dhe lëndët Manaxhim projekti dhe kontratash, Vlerësim i ndërmarrjeve etj.. Mendojmë që këto lëndë i kanë arritur objektivat dhe qëllimet e formimit të studentëve në këtë program. Në të ardhmen do të shihet mundësia e shtimit të ndonjë lënde të re.*

Sugjerimet në kriteret e tjera lidhen kryesisht me këtë problem që do vlerësohen në vazhdim.

Nisur nga sugjerimet dhe sqarimi i dhënë më lart, mendojmë se duhet rishikuar vlerësimi i këtij standardi.

Argumentimi i GVJ: Pavarësisht se institucioni ne objeksionin e tij për këtë standard, prezanton se disa prej këtyre lëndëve janë zhvilluar në nivelin bachelor, GVJ është e mendimit se lëndët si Menaxhim Operacionesh, Spërmarrje, Menaxhim i burimeve njerëzore, Sjellje Organizative, Menaxhim Strategjik, janë esenciale, për t'u zhvilluar ne nivel te avancuar ne programin master profesional, sepse lidhen me kompetencat kyce qe ky master duhet t'ju ofrojce studenteve. GVJ është i mendimit që këto lëndë, jo vetëm duhet të jenë pjesë e PS, MPAB, por ato duhet të jenë në kategorinë e lëndëve karakterizuese, për rëndësinë dhe lidhjen që kanë me formësimin e kompetencave manaxheriale, që ka si synim PS MPAB

Per sa me sipër komenti i institucionit per kete standard nuk pranohet.

Komenti i Institucionit

Kriteri 1. Studimi i tregut është fokusuar në vijim të këtij program studimi që në të ardhmen do të jetë edhe në drejtim të përmirësimit të tij

Kriteri 2. Pyetesorë për studentët, përmbajnë dhe mendime për programet e studimit që do specifikohen më hollësisht në të ardhmen. Theksojmë se edhe me studentët janë organizuar

leksione të hapura, seminare tryeza të rrumbullakta (Anex 6, dokumenta shtesë), që i kanë shërbyer studentëve për të krijuar një vision më të qartë për programet e studimit.

Kriteri 3. Viti 2018-2019, ishte viti i parë i diplomimit për këta studentë (pas rifillimit të aktivitetit të KUQ). Me këta studentë jo vetëm kemi informacion për punësimin e tyre (Anex II.13), por vazhdojmë të mbajmë komunikime me ta

Kriteri 4. Nuk kemi pasur sugjerime nga institucionet që kemi bashkëpunim të cilat duhet ti pasqyronim në PS të MPAB

Nisur nga sugjerimet Tuaja, që nuk përbëjnë vërejtje thelbësore dhe sqarimet tona, mendojmë se duhet rishikuar vlerësimi i këtij standardi

Argumentimi i GVJ

Kriteri 1. GVJ vlerëson pozitivisht qëndrimin e institucionit, që sikurse është shprehur edhe në objeksionin e paraqitur, në të ardhmen studimi i tregut, do të jetë edhe në drejtim të përmirësimit të PS, por për periudhën e akreditimit të programit për të cilën është hartuar RVJ, kjo nuk ka ndodhur.

Kriteri 2. Sugjerimi i GVJ për këtë kriter ka qenë në lidhje përdorimin e metodave të tjera alternative me proaktive për të siguruar perceptimin e studentit në lidhje me PS, si organizimin e fokus grupeve apo tryezave të rrumbullakta me pjesëmarrjen e studentëve, përveç pyetësorëve. Ndërkohë në objeksionet e paraqitura institucioni shprehet se me studentët janë organizuar leksione të hapura, seminare tryeza të rrumbullakta (Anex 6, dokumenta shtesë). Referuar kësaj shtojce të cilën GVJ e ka vlerësuar, konstatohet se tematika e këtyre leksioneve të hapura apo tryezave të rrumbullakta nuk ka pasur si qëllim, përfshirjen e studentëve për përmirësimin e programit por tematika të tjera të ndryshme

Kriteri 3. GVJ vlerëson mbajtjen e kontakteve me studentët nga ana institucionit, por kriteri në thelb synon konsultimin në mënyrë të vazhdueshme nga institucioni me studentët e diplomuar dhe marrjen prej tyre të propozimeve për përmirësimin e PS. Për sa më sipër GVJ nuk siguroi informacion gjatë vizitës në institucion por edhe institucioni në objeksionet e tij nuk paraqet informacion mbështetës për plotësimin e këtij kriteri

Kriteri 4. Referuar objeksioneve të institucionit “Nuk kemi pasur sugjerime nga institucionet që kemi bashkëpunim të cilat duhet ti pasqyronim në PS të MPAB”, GVJ vendos ta pranojë këtë objeksion, duke qenë se edhe në RVJ, jemi shprehur që nuk u sigurova praktikë për këtë kriter.

Për sa më sipër komentet i institucionit për këtë standard, nuk pranohen dhe vlerësimi përfundimtar i këtij standardi nuk ndryshon.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Administrim Biznes”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

| Standardi L1 | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. | | | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | |
| Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Programi i studimit Master Profesional “Administrim Biznesi” i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit të Biznesit, në Fakultetin e Ekonomisë, në Kolegjin Universitar Qiriazi, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit. Misioni është i shprehur në strategjinë e zhvillimit të institucionit. <i>Anex. 1.2, Plani Strategjik i KUQ</i> | | |
| Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi i studimit Master Profesional “Administrim Biznesi” promovon organizimin dhe realizimin e programeve kulturore dhe formuese në nivel kombëtar. Ai pasqyron në të gjithë elementët kujdesin dhe kontributin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore dhe shkencore të vendit. Programet e ciklit të dytë të studimeve në tërësi dhe ai i MPAB në veçanti, janë hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të lartë. <i>(Anex. 1.1, Statuti i KUQ, neni 3; Anex. 1.3, Rregullorja e KUQ, kreu IV, neni 21/b; Anex. 1.2, Plani Strategjik i KUQ, pika II)</i> | | |
| Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i studimit MPAB është në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të institucionit. Në të janë përcaktuar qartë objektivat për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë përmes njohurive bazë ekonomike që marrin në përfundim të programeve të studimit. <i>(Anex. 1.1, Statuti i KUQ, neni 3, pika e; Anex. 1.3, Rregullorja e KUQ, kreu IV, neni 21/a)</i> | | |
| Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Programi i studimit është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat lidhen me fushën e studimit, cmërtimin e programit (Anex. III-2-1). Ky program studimi është licencuar si Master i Nivelit të Dytë me 60 ECTS me VKA nr. 284 datë 20.12.2011. <i>Anex. III.2.2, Programi i studimit MP AB 2016-2018.pdf</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | ✓ | |

Standardi L2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | | | | |
|---|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p> | <p>Programi i Studimit MPAB, në Fakultetin e Ekonomisë, Kolegji Universitar “Qiriazi”, realizohet në përputhje me strategjitë afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit të institucionit.</p> <p>Anex_1_2_Plani_Strategjik_i_Zhvillimit_të_Kolegjit_Universitar_“Qiriazi”.pdf</p> | | | | | | |
| <p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentave strategjike të KUQ, (Statuti, Plani Strategjik, Rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit) dhe nga vizita në institucion, GVJ arrin në përfundim se: organizimi i programit të studimit MP AB, është bazuar në dokumenta strategjike që orientojnë misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit, të cilat kanë si objektiva kryesorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Konsolidimin e programeve të Fakultetit Ekonomik, në të gjitha ciklet e studimeve. – Forcimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me universitetet e tjera të vendit si edhe me universitete të huaja. – Angazhimin në mësimdhënie të personelit me kualifikim dhe aftësi sa më të larta profesionale. <p>Anex_1_2_Plani_Strategjik_i_Zhvillimit_të_KUQ. Anex_1_3_Rregullorja_e_KUQ_kreu_IV_neni_21. Anex_III_2_2_Programi_i_studimit_MP_AB_2016-2018.pdf</p> | | | | | | |
| <p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p> | <p>Programi i Studimit, MPAB është në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e zhvillimit të institucionit. Në të janë përcaktuar qartë objektivat për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë përmes njohurive bazë ekonomike që marrin në përfundim të programeve të studimit.</p> <p>Anex_III_2_4_Syllabus_MP_AB.pdf Anex_1_1_Statuti_i_KUQ_neni_3. Anex_1_2_Plani_Strategjik_i_Zhvillimit_të_KUQ. Anex_II_2_Plani_Strategjik_i_FE.</p> | | | | | | |
| <p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p> | <p>Departamenti i Menaxhimit të Biznesit nga i cili ofrohet programi i studimit MPAB, e mbështet zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p> <p>Sipas vlerësimit të brendshëm të institucionit (RVE Master Profesional Administrim Biznesi Final KUQ.pdf), programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në tërësi kanë si qëllim të kontribuojnë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.</p> | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | ✓ | |
| Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | ✓ | | | | | | |

Standardi I.3

Programet e studimit "Master profesional" synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Programet e studimit "Master profesional" kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.

Mbështetur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, GVJ vlerëson që programi ka një mungesë fokusi midis titullit të tij dhe kompetencave të ofruara. Në faqen 4 të misioni i programit MP dokumenti: Anex III 1 Rregullore e MP Administrim Biznesi, institucioni shprehet se: *Programi mundëson studimin teorik dhe aplikativ në fushën e administrimit të marketingut.*

Po kështu institucioni shprehet: *në rezultatet e pritshme në përfundim të këtij cikli studimesh studentët do të jenë të aftë të:*

- ✓ *Njohin fushën e Administrimit të Biznesit, mundësitë që krijon ajo për zhvillimin e suksesin e biznesit.*
- ✓ *Njohin Administrimin e prodhimit, rolin e burimeve njerëzore në administrimin e tij.*
- ✓ *Të organizojnë, menaxhojnë e drejtojnë biznese të vogla e të mesme që të jenë të suksesshem në veprimtarinë e tyre ekonomike.*

Nga shqyrtimi i programit, GVJ gjykon që këto dije nuk mund të përvetësohen me modulet e paraqitura në programin e studimit. Administrimi i marketingut dhe proceseve që lidhen me të nuk mund të realizohet vetëm me module si Marketingu Ndërkombëtar apo Çmimet dhe tregjet. Këto lëndë nuk janë lëndë karakterizuese të programit. Po kështu module si menaxhimi i burimeve njerëzore, komunikimi në biznes, menaxhimi i sipërmarrjeve janë module të cilat nuk mund pajisin studentët diplomantë me dijet e përmendura në rregulloren e programit.

Dokumenti i tregut të punës i paraqitur nga KUQ, është ndërtuar mbi një metodologji e cila nuk arrin të identifikojë qartë nevojat e tregut të punës, mungesat që ekzistojnë aktualisht dhe të ofrojë informacionin për të ndërtuar një program studimi që lehtëson integrimin e të diplomuarve në tregun e punës. Ai mbështetet vetëm në të dhëna dytësore të cilat nuk identifikojnë kompetencat e kërkuara duke e bërë të pamundur përkthimin e këtyre kompetencave në module, si dhe nuk ofron mundësi për një paraqitje të qartë të kompetencave dhe aftësive të nevojitura nga tregu i punës.

[Anex III 1 Rregullore e MP Administrim Biznesi.pdf](#)

[Anex III 2 4 Syllabus MP AB.pdf](#)

[Anex I 12 Mbi studimin e tregut punes retor 2017.pdf](#)

Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë

KUQ ka bërë përpjekje për të analizuar nevojat e tregut të punës, për të përshtatur programin e studimit por metodologjia e përdorur nuk mundëson identifikimin e kompetencave që

| | |
|--|--|
| <p>periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p> | <p>nevojiten në sektorin publik apo privat në fushën e administrimit të biznesit.</p> <p>Analiza e aktorëve potencialë në tregun e punës nëpërmjet kërkimit primar do ta plotësonte kuadrin e kompetencave dhe aftësive të kërkuara nga tregu i punës.</p> |
| <p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënilit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathhtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> | <p>Nga analiza e RVB institucioni paraqet që: Objektivat formues të programit të studimit MPAB janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▫ Formimi i ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e politikave të menaxhimit të biznesit. ▫ Formimi teorik dhe praktik i studentëve mbi fushat e strategjive të menaxhimit të biznesit në fushat e turizmit, pasurisë së paluajtshme, artit, arsimit dhe shëndetit. <p>GVJ pasi analizoi programin e studimit të MPAB konstatoi që këto objektiva nuk mbulohen plotësisht sepse nuk ofrohen module që do të mbështesnin ofrimin e kompetencave të mësipërme.</p> <p>(Anex III 1 Rregullore e programit të studimit Master në "Administrim Biznesi", neni 4; Anex III 2, 4, Syllabus MP AD", Pjesa "Përmbledhje dhe Rezultatet e të Nxënilit"; Anex I 12, Analizë e tregut të punës)</p> |
| <p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p> | <p>Struktura dhe përmbajtja e moduleve nuk mbulon plotësisht kompetencat e kërkuara nga Master Profesional në "Administrim Biznesi". Në raportin e vlerësimit të brendshëm pasqyrohet që: <i>Programi i studimit MPAB është hartuar duke u mbështetur në përvojën e universiteteve vendase dhe të huaja, duke përshtatur këto modele me kërkesat aktuale dhe perspektive të tregut të punës (RVB Master Profesional Administrim Biznesi Final KUO.pdf)</i>. Megjithatë institucioni nuk paraqet një evidencë të praktikave më të mira mbi të cilat është bazuar për hartimin e programit. Një listë e universiteteve vendase dhe të huaja mbi të cilën është mbështetur për hartimin e programit dhe një listë e kompetencave, produkt i një kërkimi të mirëfilltë tregu do të siguronin një bazë cilësore për të mbështetur hartimin e programit.</p> |
| <p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavejeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p> | <p>Programi ka të pasqyruar përmbajtjen e detajuar dhe është vlerësuar në kredite Evropiane sipas sistemit ECTS. Diploma që jepet në përfundim të programit të studimit Master shoqërohet me suplementin e diplomës.</p> <p>Ky program është vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe Kartës së Bolonjës.</p> <p>Programi i studimit, është hartuar mbi bazën e kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë në</p> |

| | udhëzimet e MAS si dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë. | | | | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|---|--|
| Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. | Programi MPAB e ka të parashikuar zhvillimin e praktikës profesionale dhe i ka akorduar dhe një peshë të caktuar me 4 ECTS. Institucioni ka një sërë marrëveshje me institucione publike dhe private, të cilat mbështesin zhvillimin e praktikës dhe aftësimin e studentëve në një fushë të caktuar të që lidhet me këtë program studimi. <u>Anex III 2 2 Programi i studimit MP AB 2016-2018.pdf</u> <u>Anex III 4 Rregullore e Praktikës Profesionale për FE.pdf</u> | | | | | | |
| Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin. | Në programin e MPAB nuk janë të përfshirë elemente të mësimdhënies, në gjuhë të huaj. (Anex III 2 4 Syllabuse e lëndëve të programit MP “Administrim Biznesi | | | | | | |
| Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar. | GVJ konstaton që institucioni nuk e aplikon këtë praktikë. | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyshet pjesërisht</th> <th>Përmbyshet kryesisht</th> <th>Përmbyshet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>✓</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | Përmbyshet pjesërisht | Përmbyshet kryesisht | Përmbyshet plotësisht | | ✓ | |
| Përmbyshet pjesërisht | Përmbyshet kryesisht | Përmbyshet plotësisht | | | | | |
| | ✓ | | | | | | |

| | |
|--|--|
| Standardi I.4 | |
| Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | KUQ është i përbërë nga: <ul style="list-style-type: none"> • Fakulteti Ekonomik (FE), • Fakulteti i Drejtësisë (FD) si dhe • Kolegji Profesional i Lartë. MP në AB ofrohet nga departamenti “Menaxhim Biznesi”. Fakulteti Ekonomik ka në përbërjen e tij 17 anëtarë si personel akademik efektiv (PAE) dhe personel akademik me kontratë (PAK). Personel akademik efektiv janë gjithsej 10 pedagogë, nga të cilët 7 janë personel akademik me grada shkencore dhe tituj akademik. Organigrama dhe statistikat e të dhënave tabelore për personelin akademik efektiv dhe të jashtëm si dhe të planet mësimore për ngarkesën e tyre tregojnë që kushti ligjor (VKM nr. 418, datë 10.05.2017), i mbulimit të programit të studimit me 70% me pedagogë të brendshëm plotësohet, sepse nga të dhënat e ofruara nga institucioni, rreth 70% e pedagogëve të angazhuar për vitin 2018-2019 janë PAE dhe 30% e pedagogëve të |

| | angazhuar janë PAK. <u>Anex II 10 Lista e personelit akademik Dep MB.pdf</u> <u>Anex III 2 1 Dosja e programit studimit MP Administrim Biznesi.pdf</u> | | | | | | |
|---|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|---|--|
| <p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p> | <p>Programi i studimit MP në "Administrim Biznesi", është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë dhe i shërben misionit të tij.</p> <p>KUQ, vepron brenda kornizave ligjore dhe respekton ligjin e arsimit të lartë në fuqi (L. 80/2015) si edhe përcaktimet statutore. Strukturat e saj janë të formësuara në mënyrë të tillë që të garantojnë arritjen e misionit të KUQ si edhe përmbushjen e objektivave të tij.</p> <p>Programi i studimit MP në "Administrim Biznesi", është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Menaxhim Biznesi dhe i shërben misionit të tij.</p> <p>Ky program është në përputhje me nivelin 7 të kornizës evropiane dhe shqiptare të kualifikimit.</p> <p>(Anex III 1 Rregullore departamentit MB, neni 10,11,12; Anex II 1 Rregullore e programit të studimit MP "Administrim Biznesi", neni 3, 4) Anex III 2 4 Syllabuse e lëndëve të programit "Administrim Biznesi", Pjesa "Përmbledhje dhe Rezultatet e të Nxëniti". (Anex III 2 Dosja e program Studimi FE MP MB)</p> | | | | | | |
| <p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p> | Institucioni nuk ka programe të tilla. | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>✓</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | ✓ | |
| Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | ✓ | | | | | | |

| Standardi L5 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> | <p>Ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit është e përcaktuar në rregulloret e brendshme të institucionit. Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësive të ndryshme, por pesha kryesore mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, nga departamenti i Menaxhimit të Biznesit. Në aktet rregullatorë janë të përcaktuara qartë roli i përgjegjësit të njësisë bazë, përgjegjësit të grup-lëndëve/koordinatorit të programit sikurse dhe ato të titullarit të lëndëve specifike. <u>Anex II 5 Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit.pdf</u>.</p> |

| | <p>Megjithatë nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga IAL por edhe nga vizita në institucion nuk paraqitet një analizë e ecurisë së programit në të cilin të analizohen arritjet si edhe të vendosen objektivat për vijimësinë.</p> <p>GVJ rekomandon që paraqitja e praktikës së vlerësimit të ecurisë së programit do të ndihmojë institucionin në realizimin e vlerësimit akademik të programit (vlerësimi i silabuseve dhe praktika e vlerësimit të tij, përputhja e moduleve me programin dhe objektivat që ai do të arrijë) si dhe vlerësimi administrativ nga njësitë e tjera si NJSCB dhe feedback-u i studentëve.</p> | | | | | | | | |
|--|--|----------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|---|--|--|
| <p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p> <p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë "Master profesional", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p> | <p>Në kuadër të realizimit të objektivave të procesit mësimor të programit MP AB, institucioni bashkëpunon me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit. Bashkëpunimi zhvillohet në drejtime të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▫ Në zhvillimin e programeve hulumtuese të përbashkëta. ▫ Në mbështetje për zbatimin e rezultateve të kërkimeve shkencore në praktikë. ▫ Mbështetje të veprimtarisë botuese shkencore. ▫ Realizimi i veprimtarive të përbashkëta kërkimore-shkencore. ▫ Realizimi i praktikave profesionale të studenteve të Kolegjit <p>GVJ rekomandon që për secilin institucion në varësi të rëndësisë dhe frekuencës së bashkëpunimit, IAL të pajiset me marrëveshje të shkruara midis palëve.</p> <p>Anex I 13 Lista e bashkëpunimit ndër-institucionale Kolegjit.pdf</p> | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p> | <p>Programi MP AB është hapur në vitin akademik 2017-2018 dhe shënohen 2 të diplomuar dhe dhe 2 të punësuar sipas Dokumentit me nr 55 «Të dhëna për punësimin e studentëve_FE» ,</p> | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në IAL, GVJ konstaton që institucioni paraqet një listë të bashkëpunimeve. Megjithatë GVJ rekomandon që në të ardhmen institucioni të hartojë një raport në të cilin të analizohen arritjet dhe të përcaktohen objektivat për të ardhmen.</p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | Përbushet plotësisht | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | ✓ | | |
| Përbushet plotësisht | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | ✓ | | | | | | | | |

| <p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | Përbushet plotësisht | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | ✓ | | |
|--|---|----------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|---|--|--|
| Përbushet plotësisht | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | ✓ | | | | | | | | |

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

| Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi. | |
|--|---|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> | <p>Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi” pranë Kolegjit Universitar “Qiriazhi” (MPAB), referuar dokumentacionit që ekspertët kanë konsultuar, rezulton të jetë i organizuar, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët kanë të përcaktuar ngarkesën dhe numrin e krediteve. [Anex III 2 2].</p> <p>Nga kjo shtojcë rezulton se për tre vitet e fundit, 2016-2017, 2017-2018 dhe 2018-2019, PS MPAB, përmban 9 lëndë, praktikën profesionale si dhe punimin e tezës së diplomës, ka 60 kredite, të organizuara në 2 semestra. Kjo përbërje rezulton e pandryshuar 3 vitet e fundit</p> <p>Semestri i parë ka një kohëzgjatje prej 15 javësh, ndërsa semestri i dytë prej 10 javësh, ndërkohë që 2 javë janë në funksion të praktikës profesionale dhe 3 javë në funksion të punimit të diplomës.</p> |
| <p>Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p> | <p>Gjykimi i ekspertëve në lidhje me kompozimin e planit mësimor të PS MPAB, është që ky plan mësimor ka në përbërje të tij, lëndë që i ofrojnë studentit njohuri teorike dhe aplikative në fushën e Administrim Biznesit, Financës, Kontabilitetit dhe marketingut, duke i shërbyer përgatitjes së administratorëve dhe manaxherëve të suksesshëm të bizneseve. Referuar shtojcave që gjenden në sistemin AMS, misioni i PS MPAB është <i>“Misioni i këtij programi është të përgatisë specialist të Administrim Biznesit” që në përfundim të programit të studimit, zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme profesionale për të menaxhuar veprimtari ekonomike të vogla, të mesme dhe të mëdha publike e private. Ky program studimi ka si mision t’i pasjisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e drejtimit dhe administrimit të biznesit. Programi mundëson studimin teorik dhe aplikativ në fushën e Administrimit të marketingut”</i>. (Anex III 2 1_Dosja e programit studimit MP Administrim Biznesi.pdf fq 4)</p> <p>Referuar misionit dhe kuptimit të tij GVJ konkludon se nëpërmjet realizimit të këtij misioni, synohet formimi i shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh, si kompetenca për të analizuar situatat e bizneseve dhe problematikat me të cilat ato ndeshen, kompetenca për të planifikuar, organizuar, motivuar, udhëhequr dhe kontrolluar.</p> <p>[Anex III 2 1 Program i studimit MSc Administrim Biznesi.pdf]</p> |
| <p>Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> | <p>Referuar përmbajtjes së PS MPAB, syllabuseve të lëndëve dhe takimit që GVJ pati me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për PS MPAB, rezulton se PS MPAB krijon mundësinë që studentët të marrin njohuri të avancuara dhe të thelluara në fushën e administrim biznesit nëpërmjet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>të fushës manaxheriale për administratorët e kompanive private ose administratorët e organizatave publike. Pavaresisht kësaj, GVJ është e mendimit që plani mësimor i MPAB për tu konsideruar i plotësuar ky kriter, për t'iu shërbyer të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës manaxheriale, duhet të përmbajë një bërthamë më të fuqishme me një gamë më të gjerë lëndësh manaxheriale, të cilët GVJ I konsideron se mungojnë në PS MPAB aktual.</p> <p>[Anex III 2 4 Syllabus MP AB.pdf; Anex III 2 1 Dosja e programit studimit MP Administrim Biznesi.pdf]</p> |
| <p>Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>GVJ mbështetur në Planin mësimor të PS MPAB, takimeve me studentë të programit si dhe me stafin akademik të përfshirë në program, është i mendimit se PS MPAB, në mënyrën si është konceptuar, nëpërmjet lëndëve që përmban, syllabuseve të tyre, si dhe mënyrës si organizohen lëndët, synon të jetë i orientuar drejt zhvillimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave të lidhura me fushën e manaxhimit, të financës, kontabilitetit të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme me të cilat ndeshen bizneset sot. Për ti shërbyer në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe për të qenë më shumë i orientuar drejt aftësive dhe kompetencave manaxheriale që studentët duhet të fitojnë, GVJ rekomandon përfshirjen e disa lëndëve të rëndësishme sic mund të jenë: Sipërmarrja, Marrja e vendimeve manaxheriale, Manaxhimi strategjik i avancuar, Sjellja organizative e avancuar, Manaxhimi i Operacioneve i avancuar.</p> <p>Këto janë lëndë të mirëfillta manaxheriale dhe në nivel të avancuar, në përputhje me kompetencat që studentët duhet të fitojnë, për të qenë të aftë, për të zgjidhur problemet komplekse manaxheriale.</p> <p>[Anex III 2 4 Syllabus MP AB.pdf; Anex III 2 1 Dosja e programit studimit MP Administrim Biznesi.pdf]</p> |
| <p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p> | <p>Rreferuar si dhe takimit me drejtuesin e njesisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se elementët që përbëjnë strukturën e PS MPAB, bazohen mbi përcaktimet e VKM 41, datë 24.01.2018 dhe analizohen më poshtë:</p> <p>a. PS MPAB, rezulton të ketë 9 lëndë, praktikën mësimore dhe punimin e diplomës. 5 Prej lëndëve kanë 6 kredite, 3 lëndë kanë 5 kredite, dy lëndë 4 kredite, punimi i diplomës përmban 7 kredite. Masteri zhvillohen në dy semestra, përkatësisht 15 dhe 10 javë. 5 Lëndët e zhvilluara në semestrin e parë, kanë ngarkesa javore, 2 leksione/ në javë dhe dy seminare/ në javë dhe zhvillohen në 15 javë, me nga 6 kredite secila.</p> <p>Lëndët e semestrit të dytë zhvillohen në 10 javë, kanë ngarkesa 3 leksione/ në javë dhe 2 seminare/ në javë dhe kanë nga 5 kredite, ndërsa 1 prej lëndëve ka ngarkesë 2 leksione/ në javë dhe 2 seminare/ në javë e vlerësuar me 4 kredite. GVJ është e mendimit se ndarja e ngarkesës dhe e krediteve është e duhura.</p> <p>b. Planin mësimor konstatohet se ka të përcaktuara dhe të deklaruara objektivat formuese që synohet të arrihen si dhe kompetencat profesionale që synohet të fitojnë studentët në përmbyllje të</p> |

studimeve të tyre në PS MPAB (Plani mësimor, faqe 5, 6)

c. Në planin mësimor gjenden të gjitha ndarjet sipas veprimtareve formuese nga A-E. Veprimtaritë formuese të tij janë të përcaktuara dhe GVJ konstaton se:

- lëndët bazë (kategoria A) kanë 10 % të krediteve,
- lëndët karakterizuese (kategoria B) kanë 40 % të krediteve,
- lëndët integruese (kategoria C) që zënë 25% të krediteve,
- lëndët plotësuese (kategoria D) 13% të krediteve, ndërsa
- kategoria E e detyrimeve përmbyllëse përmban 7 kredite ose 12% të krediteve të PS.

d. GVJ konstaton duke iu referuar VKM 41, për përbërjen e PS, kategoria D, e lëndëve plotësuese duhet të përmbajë 5%-10 %, ndërkohë që përmbanë 13 %, ndërsa kategoritë e tjera të këtij plani mësimor kanë përputhshmëri me specifikimet që VKM 41 përmban

c. GVJ konstaton se në përbërje të kategorisë A (lëndë bazë), nuk ka përputhshmëri me VKM 41, në kuptimin e lëndëve që VKM parashikon për këtë kategori. Plani mësimor aktual ka në përbërje të kategorisë A, marketingun ndërkombëtar, disiplinë që referuar edhe syllabusit të saj nuk mund të ofrojë njohuri për formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike apo kulturën e përgjithshme. Në këtë kategori mund të ishte e përshtatshme lënda e Ekonomiksit manaxherial. Gjithashtu shihet një mosperputhje në përbërjen e kategorisë D, të Lëndëve plotësuese. Në përbërje të kësaj kategorie duhet të jenë lëndë si gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale sipas VKM 41. Kjo kategori në planin aktual përmban lëndë si Cmimet dhe Tregjet si dhe Praktika profesionale. Lënda Cmimet dhe Tregjet mund të vendoseshin në kategorinë e lëndëve karakterizuese, dhe lënda Sisteme të Manaxhimit të Informacionit mund të ishte në këtë kategori. Gjithashtu GVJ është e mendimit se në kategorinë C përbërja nuk përputhet me specifikimet e VKM 41. Lëndë si Manaxhimi I Kontratave dhe projekteve, nuk konsiderohet një lëndë disiplinore por një lëndë në kategorinë karakterizuese (B). Kategoria B, ka përputhshmeri në nivel kreditesh me VKM 41, por GVJ është e mendimit se disa prej këtyre lëndëve, si Ekonomiks manaxherial si dhe sisteme të manaxhimit të informacionit nuk do të ishin karakterizuese për një program master në Administrim biznesi, ndërkohë që në planin mësimor mungojnë lëndë si Manaxhim Strategjik I avancuar, Sipërmarrje, Burime Njerezore, Sjellje Organizative, të cilat bashkarisht ose një pjesë e tyre, duhet të jenë në këtë kategori, do të përbënin bërthamën e këtij program master.

GVJ është e mendimit se plani mësimor i PS MPAB duhet të rishikohet përsa i përket shpërndarjes së krediteve sipas kategorive të disiplinave në mënyrë që të ketë përputhshmëri me hartimin e planit sipas VKM 41, por mbi të gjitha në terma të disiplinave sipas

| | <p>kategorive. (sipas përcaktimeve të VKM 41)</p> <p>f. Në planin mësimor janë të përcaktuara edhe kuotat e regjistrimit për çdo vit nga 1-120 studentë. GVJ duke iu referuar rregullores së programit, neni 12 faqe 5, konstaton se aty deklarohet numri minimal prej 15 studentësh. GVJ është e mendimit se numri minimal i përcaktuar në PS nuk mund të jetë 1 student, pasi nuk krijon kushte për zhvillim normal të procesit mësimor. GVJ sugjeron zbatimin e rregullores për këtë argument.</p> <p>GVJ konstaton se Syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e Titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar. Megjithatë modeli që përdoret për hartimin e tyre, nuk është bazuar në modelin e përcaktuar në <i>VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca no.2)</i>. Në disa lëndë literature është relativisht e vjetëruar, ndërkohë që VKM 41, konsideron literaturën e 5 viteve të fundit</p> <p>Në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomë e cila shoqërohet edhe me suplementin përkatës. GVJ konsultoi në sistemin e ASCAL, këto dokumenta, të cilat kanë elementët e duhur në përbërje dhe janë në përputhje me emërtimin e programit.</p> <p>Anex III 2 i Dosja e programit studimit MP Administrim Biznesi.pdf Anex III 1 Rregullore e Program Studim FE Msc Admin Biznes.pdf, [VKM 41] Anex III 2 4 Syllabus MP AB.pdf Anex III 3 2 1 Model Suplement Diplome.pdf Anex III 3 2 DIPLOMAT MP administrim biznesi fin.pdf</p> | | | | | | | | |
|---|--|----------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|---|--|--|
| <p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p> | <p>GVJ konstaton se në planin mësimor të PS MPAB, për praktiken profesionale, janë parashikuar 4 kredite, 40 ore të zhvilluara në dy javë.</p> <p>Anex III 2 1 Program i studimit MSc Administrim Biznesi.pdf, Anex III 1 Rregullore Program Studim FE Msc Admin Biznes.pdf,</p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | Përbushet plotësisht | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | ✓ | | |
| Përbushet plotësisht | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | ✓ | | | | | | | | |

| Standardi II.2 | |
|---|--|
| Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> | <p>Institucioni është licensuar me VKM nr. 274 datë 10.05.2006. Ndërkohë pas një periudhe pezullimi, IAL liçensohet për rifillimin e veprimtarisë me Urdhër 397 të MASR të datës 22.07.2016.</p> <p>KUQ është akredituar institucionalisht, sipas VBA-ASCAL, nr 24 të datës, 11.05.2018.</p> <p>Programi i studimit MPAB është akredituar, me UMASH nr. 47</p> |

| | |
|--|---|
| | datë 09.02.2011, me kohëzgjatje 1 vit akademik, 60 kredite (me VKA nr. 284 datë 20.12.2011) |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Fakulteti i Ekonomisë, pranë KUQ, ka në përbërje dy departamente dhe një qendër kërkimore, Departamenti i Manaxhim Biznesit, Departamenti i Financës, si dhe Qendrën Kërkimore- Shkencore. Departamenti i Manaxhim Biznesit ofron programin e ciklit të parë të studimit Bachelor “Menaxhim Biznesi” dhe programet e ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave dhe Master Profesional përkatësisht në “Menaxhim Biznesi” dhe në “Administrim Biznesi”. Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për PS MPAB, janë të përcaktuara në statut dhe në Rregulloren e Fakultetit, të cilat janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. |
| Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar. | Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor i Asociuar” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “Doktor i Shkencave” Fakulteti i Ekonomisë pranë KUQ, ka në përbërje të tij 17 pedagogë si Personel akademik efektiv, të organizuar në dy departamente dhe 1 qendër kërkimore. <u>Departamenti i Manaxhim Biznesit ka</u> - 5 anëtarë si personel akademik efektiv, ndër të cilët 3 janë me gradë shkencore /titull akademik. - 3 anëtarë si personel akademik me kontratë, të cilët janë me gradë shkencore /titull akademik. <u>Departamenti i Financës, ka</u> - 5 anëtarë si personel akademik efektiv, ndër të cilët 4 janë me gradë shkencore /titull akademik. - 4 anëtarë si personel akademik me kontratë, të cilët janë me gradë shkencore /titull akademik. <u>Qendra kërkimore shkencore e fakultetit ka:</u> - 7 anëtarë si personel akademik efektiv, ndër të cilët 3 janë me gradë shkencore Përsa më sipër GVJ konstaton se të dy njësitë kryesore dhe qendra kërkimore, plotësojnë detyrimet ligjore për nivelin e kualifikimit të personelit akademik. GVJ referuar <u>Anex II 7 Numri i stafit Akademik FE 2016-2018.pdf</u> , ku institucioni deklaron të dhënat për stafin akademik efektiv për vitet 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019, konstaton se numri i stafit efektiv, që të dy njësitë bazë kanë nga 5 anëtarë, ndërkohë që kriteri ligjor minimal, është 7 anëtarë - staf efektiv, për çdo njësi të bazë. Institucioni, me rifillimin e procedurës së akreditimit nga ASCAL, ka deklaruar se e ka plotësuar numrin minimal prej 7 anëtarësh dhe kjo vlerësohet pozitivisht nga GVJ, |
| Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | |

| | <p>por GVJ gjykon se kjo nuk mund të ndikojë në vlerësimin që bëhet dhe në të dhënat për dy vitet e shkuara, për të cilat akreditohet ky program. Ky shpjegim sqaron edhe mospërputhshmërinë mes të dhënave të deklaruara në RVJ.</p> <p>Anex II 1.1 Organigrama e Fakultetit Ekonomik.pdf, Anex II 7 Numri i stafit Akademik FE 2016-2018.pdf</p> | | | | | | | | |
|---|--|-----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|--|
| <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p> | <p>GVJ nga vizita në institucion por edhe nga dokumentacioni i depozituar, konstaton se njësia kryesore dh ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit MP AB, angazhon personelin akademik ndihmës te nevojshëm për realizimin e praktikave, nisur edhe nga numri i vogël i deritanishëm i studentëve. GVJ konstatoi nga takimi me studentët, se institucioni angazhon personel akademik ndihmës të mjaftueshëm, të cilët asistojnë studentët si dhe facilitojnë përmbushjen e këtyre detyrimeve</p> | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> | <p>PS ne MPAB, ka të përcaktuar në rregulloren e programit emerimin e koordinorit të programit.</p> <p>Nga informacioni i siguruar nga RVB si dhe nga vizita në institucion, rezulton se koordinor i PS ne MPAB, është përgjegjësi i Departamentit të Manaxhim Biznesit përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij.</p> | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p> | <p>GVJ rekomadon që koordinor i programit, në këtë rast edhe përgjegjës i departamentit, të raportojë periodikisht për ecurinë e e PS MPAB dhe të dokumentojë çdo informacion që lidhet me programin e studimit, me qëllim adresimin zgjidhjen e problematikave të identifikuara për të ardhmen</p> <p>Anex III 1 Rregullore e MP Administrim Biznesi.pdf</p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyllet plotësisht</th> <th>Përmbyllet pjesërisht</th> <th>Përmbyllet kryesisht</th> <th>Përmbyllet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | Përmbyllet plotësisht | Përmbyllet pjesërisht | Përmbyllet kryesisht | Përmbyllet plotësisht | | | ✓ | |
| Përmbyllet plotësisht | Përmbyllet pjesërisht | Përmbyllet kryesisht | Përmbyllet plotësisht | | | | | | |
| | | ✓ | | | | | | | |

| Standardi II.3 | |
|--|---|
| Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë: | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, GVJ konstatoi se për PS në MPAB, njësia kryesore dhe ajo bazë kanë informacionin e duhur për organizimin e këtij masteri, si rregullorja e programit, plani mësimor, shpërndarja e lëndëve sipas pedagogëve.</p> <p>Anex II 1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf; Anex II 5 Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit .pdf; Anex III 1 Rregullore e MP Administrim Biznesi.pdf; Anex III 2 5 Te Dhenat e Stafit Akademik MSC Administrim Biznesi.pdf Aneks/Shtojce Ngarkesa mësimore në MP dhe MSc ne Administrim</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p> <p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p> | <p><u>Biznesi, MP dhe Msc Administrim Biznes, Kolegji Universitar Qiriazi</u></p> <p>Referuar planit mësimor të PS MPAB, konstatohet se plani është i organizuar në lëndë, të ndara sipas kategorive që përmban udhëzimi 41 i MASR.</p> <p>Programi i studimit, për çdo lëndë ka të përcaktuar kategorinë të cilës i përket si dhe numrin e krediteve sipas sistemit ECTS, vitin dhe semestrin kur lënda zhvillohet. Rezulton se lëndët kanë 6, 5 ose 4 kredite. Mbrojtja e diplomes ka 7 kredite.</p> <p>Programi zhvillohet në 2 semestra. Kohëzgjatja e programit është 1 vit, me 60 kredite në total.</p> <p>Në programin mësimor të MPAB, konstatohet se ka informacion të plotë për ndarjen e çdo lënde në komponentët leksion / seminar, orët në auditor/jashtë auditorit, dhe kreditet për çdo aktivitet.</p> <p>Në planin mësimor të 3 viteve të fundit vihet re se nuk asnjë ndryshim. GVJ rekomandon që plani mësimor t'ju nënshtrohet ndryshimeve periodike, në mënyrë që të përshtatet me bazën ligjore për nivelin e krediteve, por mbi të gjitha për përbërjen e çdo kategorie sipas VKM 41</p> <p>Referuar rregullores së programit master në sistemin AMS, rezulton se janë të parashikuara dhe të përcaktuara klauzolat për skemën e vlerësimit të studentëve si dhe për detyrimin e studentëve për nivelin e frekuentimit të programit.</p> <p>Kontrolli i dijës për studentët e MPAB, realizohet nëpërmjet vlerësimit gjithësemestral. Skema e vlerësimit për çdo komponentë të kontrollit të dijës është e ndryshme në lëndë të ndryshme. Kështu:</p> <ul style="list-style-type: none"> - në 5 prej lëndëve skema e vlerësimit është: Pjesëmarrja dhe aktivizimi në seminare 20 pikë, Kontrolli i ndërmjetëm 20 pikë, Detyra e Kursit 10 pikë dhe provimi përfundimtar 50 pikë, - ndërsa në katër prej lëndëve skema e vlerësimit është 40 pikë vlerësimi semestral dhe 60 pikë provimi final. <p>GVJ është e mendimit se të dyja këto skema vlerësimi krijojnë mundësi të nxitjes dhe aktivizimit të studentëve gjatë gjithë semestrit, duke përdorur forma alternative vlerësimi të duhurat për një mjedis heterogjen studentësh dhe duke i shërbyer formësimit dhe përvetësimit të dijeve të qëndrueshme.</p> <p>[Anex III 1 Rregullore e MP Administrim Biznesi.pdf] Anex III 2 1 Dosja e programit studimit MP Administrim Biznesi.pdf]</p> |
| <p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit,</p> | <p>Në rregulloren e PS MPAB, rezulton se ka informacion të plotë për kriteret që duhet të plotësojnë studentët, kushtet për transferimin e studimeve, numrin minimal të studentëve që parashikohet të jetë 15 studentë.</p> |

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Anex_III_1_Rregullore_e_MP_Administrim_Biznesi.pdf | | |
| Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | <p>Programi i studimit shoqërohet me syllabuset e çdo lënde. GVJ nga shqyrtimi i syllabuseve, konstaton se në këto syllabuse ka informacion për objektivat, për literaturën, për formatet e organizimit, mënyrën e vlerësimit etj.</p> <p>GVJ konstaton se Syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e Titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar. Megjithatë modeli që përdoret për hartimin e tyre, nuk është bazuar në modelin e përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca no.2). Në disa lëndë literature është relativisht e vjetëruar, ndërkohë që VKM 41, konsideron literaturën e 5 viteve të fundit</p> <p>Anex_III_2_4_Syllabus_MP_AB.pdf</p> <p>Anex_III_2_3_1_Stafi_MP_AB.pdf</p> | | |
| Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | <p>Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion dhe takimi me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për PS MPAB, rezulton se program i studimit për tre vitet e fundit që GVJ ka dokumentacion, nuk ka ndryshuar. GVJ rekomandon që plani mësimor I MP AB, t'ju nënshtrohet në mënyrë të vazhdueshme ndryshimeve, me qëllimin e përputhshmërisë me aktet nënligjore por edhe me kërkesat e një tregu pune dinamik si dhe për të reflektuar edhe rekomandime të ekspertëve të jashtëm, apo të studentëve si dhe të bizneseve partnere.</p> <p>Anex_III_2_2_Programi_i_studimit_MP_AB_2016-2018.pdf</p> | | |
| Shtylla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | ✓ | |

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | <p>Referuar PS ne MPAB, përmban</p> <ul style="list-style-type: none"> - 60 Kredite, - Orë 1500, 600 orë në auditor/900 orë jashtë auditorit - Cdo semestër ka 750 orë, 300 orë në auditor, 450 orë jashtë auditorit - 20 Orë/ javë semestri parë (15 javë), 22 orë/javë semestri i dytë (10 javë) <p>GVJ është e mendimit se ngarkesa e programit të studimit është</p> |

| | |
|--|--|
| | strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. |
| <p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p> | <p>GVJ është e mendimit se programi ka një mungesë fokusi dhe përputhshmërie, midis emërtimit të tij dhe lëndëve që përmban, të cilat sygjerohen të ndryshojnë duke ofruar lëndë të tilla manaxhim operacionesh, manaxhim strategjik të avancuar, sipërmarrje, sjellje organizative, manaxhim burimesh njerëzore, të cilat do të mundësojnë mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme si dhe për punësimin e studentëve që vazhdojnë këtë PS në përputhje me emërtesën e programit të studimit.</p> |
| <p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p> <p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> | <p>1. Referuar <u>Anexit III 2.1 Program i studimit MP Administrim Biznesi .pdf</u>, dhe konkretisht objektivave të deklaruar të programit fq 5 citojmë “<i>Objektivat kryesore të programit janë:</i></p> <p>a) <i>Të përgatisë studentët për të qenë “lider të mendimit dhe veprimit” kryesisht në organizatat e biznesit dhe ato jofitimprurëse, por jo vetëm,</i></p> <p>b) <i>Të përgatisë studentët që të jenë të aftë të pozicionohen në karrierën profesionale në fushën e Administrimit dhe administrimit në sektorin privat dhe në atë publik,</i></p> <p>c) <i>Të përgatisë dhe formojë specialistë të aftë, të cilët do të jenë në gjendje të drejtojnë në sipërmarrje të vogla dhe të mesme, si dhe të kryejnë role të rëndësishme në administrimin e shoqërive tregtare.</i></p> <p>2. <i>Ky program ka për qëllim t’u mësojë studentëve kombinimin e dijeve teorike me aftësi konkrete, si dhe aftësinë për të zbatuar në praktikë koncepte abstrakte teorike, në mënyrë që të jenë të aftë të përshtaten, të orientohen, dhe të kenë sukses në dinamikat komplekse të tregut të lirë.</i></p> <p>3. <i>Të përgatisë studentë të aftë për të vazhduar pa asnjë lloj kufizimi studimet në Ciklin e Dytë, në “Master i Shkencave”, të strukturuar sipas parimeve dhe Standardeve Europiane të Arsimit të Lartë.”</i></p> <p>GVJ është e mendimit se këto objektiva, së pari përkojnë më shumë me objektiva të një masteri me orientim shkencor (“lider të mendimit dhe veprimit”), por nga ana tjetër referuar planit mësimor, vihen re se këto objektiva nuk mbulohen mirëfill in ga lëndë që do të bënin arritjen e tyre, si lëndë të sipërmarrjes (referuar objektivit 2), teori moderne manaxhimi (referuar objektivit 1 “lider të mendimit”)</p> <p>Të njëjtin qëndrim shpreh GVJ përsa i përket rezultateve të pritshme, ku citohet “<i>Njohin Administrimin e prodhimit, rolin e burimeve njerëzore në Administrimin</i>”, por referuar Planit mësimor të MPAB, lëndë të tilla si manaxhim prodhimi apo burime njerëzore dhe sjellje organizative nuk janë pjesë e këtij</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>plani mësimor.</p> <p>Natyrisht arritja e këtyre objektivave të PS në MPAB, presupozohet se do të realizohet nëpërmjet lëndëve që PS përmban.</p> <p>Sikurse GVJ konstaton, vihet re se numri i lëndëve manaxheriale që duhet të përbëjë bërthamën e PS në MPAB, është i vogël, mungojnë lëndë manaxheriale të cilat do t'i shërbenin plotësisht të objektivave të PS. GVJ konstaton se PS MPAB, nuk i përmban lëndët e:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimit të operacioneve - Sipërmarrjes - Menaxhimit të burimeve njerëzore - Sjelljes organizative - Manaxhim strategjik <p>që konsiderohen disiplinat e nevojshme për t'u përfshirë në PS MPAB, për të plotësuar objektivat e deklaruara.</p> <p>GVJ rekomandon rishikimin e objektivave dhe rezultateve të pritshme, për tu përshtatur më nivelin e masterit profesional si dhe rishikimin e planit mësimor duke integruar në të lëndë të përmendura më sipër, të cilat së pari do ti bënin objektivat të arritshme dhe së dyti do të forconin bërthamën e lëndëve karakterizuese të PS MPAB dhe rrisnin përputshmërinë me emertimin e diplomës që ky program master lëshon.</p> <p>GVJ për ngarkesën në kredite dhe raportin leksion /seminar gjykon se është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare</p> |
| <p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>Referuar Anex III 2 1 Dësja e programit studimit MP Administrim Biznesi.pdf, Raporti leksion/seminar është kryesisht 1/1, duke mundësuar përfundimin e njohurive teorike dhe aplikimin e tyre nga studentët. Gjithashtu referuar syllabuseve të lëndëve si dhe takimeve me studentë dhe stafin akademik të programit, GVJ konstatoi se studentët përfshihen në detyra, raste studimore me fokusin e lidhjes së teorisë me praktikën, duke i shërbyer mobilitetit dhe punësimit më të mirë të studimeve në sajë të aftësive praktike më të mira në përfundim të studimeve. Anex III 2 4 Syllabus_MP_AB.pdf</p> |
| <p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> | <p>GVJ nga takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe atë bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve, konstaton se jo të gjitha, lëndët kanë literaturën të 5 viteve të fundit. [Anex III 2 4 Syllabus_MP_AB.pdf]</p> |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p> | <p>GVJ është e mendimit që përmbajtja e PS MPAB garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën e ekonomisë, por që t'ju shërbejë specifikisht ofrimit të kompetencave dhe aftësive praktike manaxheriale, të cilave duhet t'ju shërbejë MPAB, sugjerohet përfshirja e lëndëve të sugjeruara në kriterin 3 dhe 4 të këtij standardi</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p> | <p>Organizimi i lendeve në PS, duke u mbështetur në detyrat individuale, rastet studimore si dhe diskutimet i shërben potencialisht sigurimit të aftësive, kompetencave dhe formim të thelluar profesional, por natyrisht numri shumë i vogël i studentëve është një sfidë për stafin akademik dhe për student e programit, sepse nuk krijon mundëpër detyra komplekse, detyra grupi dhe diskutime.</p> | | | |
| <p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>GVJ sic është shprehur edhe më sipër, rekomandon që programi i studimit në mënyrë që të mundësojë punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, nëpërmjet kompetencave të fituara, të përshtatet në vazhdimësi, për të përfshirë lëndët e sugjeruara në kriteret 3 dhe 4 të këtij standardi të cilat ju shërbejnë fitimit nga ana e studentëve të aftësive dhe kompetencave kryesore manaxheriale të vlerësueshme në tregun e punës.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | ✓ | | |

| <p>Standardi II.5</p> | |
|---|---|
| <p>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> | <p>Stafi akademik i përfshirë në PS MPAB, është me tituj ose gradë shkencore, dhe konkretisht, 57% i përkasin kategorisë profesor dhe 43% kategorisë “Doktor i shkencave”. Përsa më sipër, personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në PS MPAB, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket kualifikimit.</p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se për vitin 2018-2019, janë përfshirë në mësimdhënie 7 pedagogë, ndër të cilët 4 janë staf akademik efektiv dhe 3 janë staf akademik joefektiv. (Ndërkohë, konstatohet se duhet të ketë lapsus në tabelat e raportuara, pasi lektori F.B, në Aneksin e stafit te departamentit te departamentit te Finances, raportohet si staf joefektiv ndërsa në Aneksin e stafit të programit si staf efektiv.</p> |
| <p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> | <p><u>Anex III 2.3.1 Staf MP AB.pdf; Anex II 10 Lista e personelit akademik Dep MB.pdf</u></p> <p>Referuar kësaj shpërndarje rezulton se nga pikëpamja numerike 57 %, janë PAE dhe 43% janë PAK, ndërkohë që kërkesat ligjore për stafin akademik është që të paktën 70 % të jenë staf efektiv [VKM 418, Maj 2017]. Duke iu referuar mbulimit te krediteve, në MPAB, rezulton se 80% e krediteve mbulohe nga stafi efektiv dhe 20% nga stafi joefektiv. Për sa më sipër institucioni duhet të rrisë numrin e stafit efektiv të përfshirë në program, për të arritur të paktën nivelin minimal sipas VKM së sipërcituar.</p> |



| | <p>Referuar CV të stafit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme, GVJ është e mendimit se stafi akademik i përfshirë në program, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik, titull akademik dhe/ose gradë shkencore si dhe eksperiencën e duhur për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> <p>Referuar CV-ve të stafit si dhe PS, rezulton se fusha akademike kërkimore shkencore e përgjithshme dhe specifike janë në përputhje me natyrën e lëndëve që ata mbulojnë në PS MPAB.</p> <p>Anex III 2 4 Syllabus MSC AB.pdf</p> | | | | | | | | |
|--|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|---|--|--|
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëhoqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> | <p>GVJ konstatoi se KUQ, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione e organizata të biznesit, por sugjeron që në këto marrëveshje ose të tjera që institucioni do të lidhë në të ardhmen, të parashikohet në mënyrë eksplicite, vendosja në dispozicion e stafit të duhur për instruktimin e studentëve për realizimin e temës së diplomës.</p> <p>Aneks/Shtojce Lista e bashkëpunimit rezultative në aktivitete, MP dhe Msc Administrim Biznes, Kolegji Universitar Qiriazi</p> | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> | <p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se personeli ndihmës mësimor shkencor është i angazhuar për realizimin e orëve mësimore, mirëmbajtjen e laboratorëve, funksionimin e bibliotekës etj.</p> <p>Institucioni duhet të garantojë një ndarje funksionale dhe më efektive të detyrave dhe minimizimin e mbivendosjes së detyrave që stafi realizon, për të pasur angazhimin e duhur dhe efektivitetin e duhur në proceset mbështetëse që ky staf performon</p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përfunduar</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | Përfunduar | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | ✓ | | |
| Përfunduar | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | ✓ | | | | | | | | |

| <p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</p> | |
|---|---|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p> | <p>Referuar takimeve me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë reformimi i planit mësimor, të MPAB, është ndërmarrë për të rritur përputhshmërinë me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Institucioni ka realizuar një studim të tregut të punës, por GVJ nuk siguroi evidencë sesi ky studim tregu apo konsultimi me bashkëpunëtorët dhe nga tregu i punës, reflekton ndryshimin në PS.</p> <p>Anex 1 12 Mbi studimin e tregut punes tetor 2017.pdf</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit,</p> | <p>KUQ, nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, synon të sigurojë informacion për efektivitetin dhe mbarëvajtjen e studimeve të tyre në PS MPAB. Referuar takimit me studentët, me stafin akademik si dhe</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. | drejtues, këto pyetësorë drejtohen për stafin akademik të përfshirë në PS. GVJ është e mendimit që pyetësori për studentët të përmbajë edhe një seksion pyetjesh për përmirësimin e programit të studimit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Gjithashtu sugjerohet përfshirje edhe të metodave të tjera alternative me proaktive për të siguruar perceptimin e studentit në lidhje me PS, si organizimin e fokus grupeve apo tryezave të rrumbullakta me pjesëmarrjen e studentëve. [Anex II 12 Pyetësoret për studentet FE 2017_2018.pdf] | | | |
| Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merret prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit. | Pranë KUQ, është ngritur Zyra e Këshillimit të Karrierës, por GVJ sugjeron që institucioni nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës të krijojë rrjetin alumni, të mbajë kontakte të vazhdueshme me ish - studentët e programit dhe të fakultetit, për të siguruar prej tyre informacion në lidhje me punësimin por edhe përmirësimin e programit të studimit. [Anex II 1 1 Organigrama e Fakultetit Ekonomik.pdf] | | | |
| Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi. | GVJ gjatë vizitës në institucion siguroi informacion për institucionet me të cilat KUQ ka bashkëpunim dhe marrëveshje, por nuk konstatoi përditësime të PS MPAB, të sugjeruara nga ky bashkëpunim. Referuar argumentave të paraqitur në vizitë, nga institucionet me të cilat KUL ka bashkëpunim, nuk ka pasur sugjerime të cilat duhet t'i pasqyronin në PS të MPAB. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përfundimisht | Përmbyshet pjesërisht | Përmbyshet kryesisht | Përmbyshet plotësisht |
| | | ✓ | | |

| | | | | |
|--|----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Përfundimisht | Përmbyshet pjesërisht | Përmbyshet kryesisht | Përmbyshet plotësisht |
| | | ✓ | | |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| | |
|---|--|
| Standardi III.1 | |
| Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e informacionit të ASCAL, nga takimet me drejtues të njëjësive kryesore dhe bazë, rezultojnë se KUQ ka hartuar Udhëzues për metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit. [Anex 1 18 Sistemi Informatik dhe Metodat e Mësimdhënies Anex 1 7 1 Udhëzues për kualifikimin e stafit akademik] |
| Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse | GVJ konstatoi se njësi bazë dhe NJSBC, zhvillojnë mekanizma |

| | | | |
|---|---|-----------------------------|------------------------------|
| <p>zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> | <p>monitorimi me qëllim vlerësimin periodik dhe të vazhdueshëm të aftësive mësimdhënëse, duke përcaktuar edhe objektivat për të ardhmen. Këto mekanizma fokusohen kryesisht në pyetësorët e studentëve që organizohen dy here në vit, vlerësimi i kontrollit në orën e mësimit të pedagogut nga ana e drejtuesëve si dhe ankimimet e studentëve.</p> <p>[Aneks/Shtojce Sondazhi i studentëve, formulari i plotësuar MP Administrim Biznes, Kolegji Universitar Qiriazi, Aneks/Shtojce Vlerësim i kontrollit në orën e mësimit të pedagogut, praktike konkrete, MP Administrim Biznes, Kolegji Universitar Qiriazi]</p> | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> | <p>Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, rezultoi se studentët para përfundimit të çdo semestri përfshihen në sondazhet për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Drejtuesit e njesisë kryesore dhe asaj bazë janë të angazhuar për trajtimin e ankimimeve, nëpërmjet metodave të cilat janë të sanksionuara dhe në rregulloren e PS MPAB [Aneks/Shtojce Sondazhi i studentëve, formulari i plotësuar konkretisht, MP Administrim Biznes, Kolegji Universitar Qiriazi]</p> | | |
| <p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> | <p>NJSBC si njësi përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në KUQ, realizon sondazhet e studentëve dhe harton raportin vjetor me gjetjet e këtij studimi i cili prezantohet në senatin akademik të KUQ, gjithashtu ky raport publikohet në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>[Anex_1_15_2_Raport Vjetor 2016-2017; www.qiriazi.edu.al]. -</p> | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> | <p>Referuar takimeve në institucion rezultojnë se KUQ ka organizuar leksione të hapura për të gjithë stafin akademik, e me fokus dy drejtime kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shkëmbimin e përvojës në organizimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështetur në praktikat më të mira. 2. Njohjen më mirë me elementët e didaktikës dhe psikologjisë. Këto leksione cilësohen të jenë të rëndësishme pasi mundësojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe metodave inovative të mësimdhënies dhe mësimnxënies ndërmjet brezave të ndryshëm. <p>[Aneks/Shtojce Lista e veprimtarive të kolegjit, MP dhe Msc Administrim Biznes, Kolegji Universitar Qiriazi]</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | ✓ |

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet,</p> | <p>Referuar rregullores së programit, Syllabuseve të lëndëve si dhe takimeve me staf dhe studentë të PS MPAB, GVJ konstaton se në PS MPAB, përdoren forma alternative leksione/seminar/ detyra grupi/detyra kursi. Mes specifikimeve që ka rregullorja dhe</p> |

| | |
|---|--|
| <p>praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p> | <p>përcaktimeve të këtyre formave në syllabus dhe në aplikim GVJ konstaton se ka përputhshmëri.</p> <p>Referuar PS MPAB dhe Planit Mësimor, rezulton se çdo lëndë e semestrit të parë zhvillohet në 15 javë, në ngarkesën 2 leksione/javë dhe 2 seminare/javë dhe 6 kredite. Për çdo lëndë të semestrit të parë realizohen 30 ore leksione dhe 30 orë seminare (orë në auditor) dhe 90 orë punë e pavarur jashtë auditorit, respektivisht 45 orë punë e pavarur për leksionet dhe 45 orë punë e pavarur për seminarat. 3 Lëndë të semestrit të dytë zhvillohen në ngarkesën 3 leksione/2 seminare dhe kanë nga 5 kredite, 30 ore leksion, 20 ore seminar, 90 ore jashtë auditorit. 1 lëndë ka 4 kredite, me ngarkesën 2 leksione/2seminare/javë, përgjatë 10 javëve, respektivisht 40 orë në auditor/60 orë jashtë auditorit. Këto forma leksione/seminare dhe praktikë mësimore janë të miraturo nga institucioni në planin mësimor të PS MPAB.</p> <p>Në planin mësimor, në total rezultojnë në auditor:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione 260 orë mësimore • Seminare 230 orë mësimore • Praktikë profesionale 40 orë mësimore • Punim diploma 40 orë mësimore • Gjithsej në auditor 570 orë mësimore <p>[Anex III 1 Rregullore e Program Studim PE MP Admin Biznes.pdf; Anex III 2 4 Syllabus MPAB.pdf]</p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p> | <p>Referuar takimeve me studentë dhe stafin akademik të programit rezulton se, stafi akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke përshtatur dhe ofruar mundësi dhe forma alternative të mësimdhënies, të kontrollit të dijes dhe duke qenë proaktiv për të përmirësuar mësimdhënien e tij. Kështu u konstatua nga takimi me studentët se përveç leksioneve, gjatë seminareve përpos kontrollit të njohurive nëpërmjet pyetjeve/përgjigjeve, diskutimeve, aplikohen edhe: a) rastet studimore, b) detyrat individuale, c) analizat krahasuese mes praktikave më të mira në kontekstin e bizneseve shqiptare.</p> <p>GVJ rekomandon që këto forma alternative të jenë më të formalizuara dhe të jenë të pasqyruara edhe në syllabuset e lëndëve, duke krijuar mundësinë edhe për follow-up e tyre, nga strukturat mbikëqyrëse të PS MPAB</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p> <p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e</p> | <p>Nga vizita në institucion rezulton se KUQ, me synimin e përmirësimit të kompetencave didaktike, të metodologjive të mësimdhënies, ka zhvilluar leksione të hapura apo trajnime për stafin akademik.</p> <p>GVJ, referuar CV, fushave të ekspertizës, eksperiencës së stafit, takimeve me studentët dhe perceptimeve të tyre, është i mendimit se, stafi akademik i programit zotëron kompetencat e duhura të mësimdhënies.</p> <p>KUQ nëpërmjet anketave të studentëve, degjimit në auditor etj, paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave të studentëve, synon vlerësimin dhe vendos objektivat për përmirësimin e metodave didaktike, por GVJ</p> |

| | | | | | | | | | |
|---|--|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|---|--|
| <p>njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> <p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p> <p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>sygjeron që ky proces të jetë më i formalizuar dhe të dokumentohet.</p> <p>Informacioni i siguruar nga studentët, gjatë vizitës në institucion dëshmon se stafi akademik përdor metoda të ndryshme interaktive për të ndërthtur teorinë me praktikën, por edhe për të rritur atraktivitetin e orëve të mësimi.</p> <p>Numri i vogël i studentëve, në PS MPAB, rrit mundësinë e fleksibilitetit në përdorimin e metodave alternative, por nga ana tjetër krijon mundësinë për më tepër detyra individuale sesa grupi, duke inkurajuar autonominë e tyre, por duke pasur në fokus respektimin e rregullores si dhe të përcaktimeve në syllabus.</p> <p><i>Aneks/Shtojce Lista e veprimtarive të kolegjit, MP dhe Msc Administrim Biznes. Kolegji Universitar Qiriazi]</i></p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmushjes së standardit</p> | <table border="1"> <tr> <td data-bbox="542 907 702 974">Përmushet pakësisht</td> <td data-bbox="702 907 925 974">Përmushet pjesërisht</td> <td data-bbox="925 907 1141 974">Përmushet kryesisht</td> <td data-bbox="1141 907 1388 974">Përmushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> <td></td> </tr> </table> | Përmushet pakësisht | Përmushet pjesërisht | Përmushet kryesisht | Përmushet plotësisht | | | ✓ | |
| Përmushet pakësisht | Përmushet pjesërisht | Përmushet kryesisht | Përmushet plotësisht | | | | | | |
| | | ✓ | | | | | | | |

| | |
|---|--|
| <p>Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> | <p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se sallat e leksioneve/ seminareve dhe laboratorëve, janë të mjaftueshme, duke pasur parasysh edhe numrin e vogël të të studentëve. Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se godina përmban tri salla për leksione, shtatë klasa për seminare dhe katër laboratorë, një prej të cilave është laborator i informatikës, një laborator elektronik, biblioteka, librari, një laborator kimi-teknologji ushqimore dhe një salle informatike e cila shërben dhe si sallë interneti për të gjithë studentët e KUQ. Këto ambiente rezultojnë të jenë në standardet normale të mirëmbajtjes dhe kushteve higjieno-sanitare.</p> <p><i>[Raport Vlerësimi (Relacion i ambienteve mësimore të Kolegjit; Planimetria e tri kateve)]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p> | <p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor të PS MPAB, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme, poste ulje, tavolina, pod lekturimi, white bord videoprojektor.</p> <p>GVJ është i mendimit se institucioni duhet të realizojë edhe mbulimin me internet të këtyre hapësirave. Gjithashtu ambientet e</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>bibliotekës duhet të jenë më të përshtatshme dhe më funksionale. Pajisja e saj me kompjutera, me më tepër poste ulje, me mundësinë e aksesimit elektronik të një data base librash/revistash, kondicioner etj. duhet të konsiderohen nga ana e institucionit</p> |
| <p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p> | <p>Referuar RVB, dhe informacionit të siguruar në institucion, KUQ përdor sistem informacioni të integruar, i cili krijon mundësi për një manaxhim të integruar të MOODLE.</p> <p>Sugjerohet që njësi bazë, stafi akademik i PS dhe stafi administrativ të intensifikojë përdorimin e këtij sistemi për të shfrytëzuar potencialet që ai ofron dhe që do t'i shërbejë proceseve efektive mësimore, por edhe dokumentimit të tyre.</p> |
| <p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p> | <p>GVJ nga takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe atë bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve, konstaton se jo të gjitha lëndët, kanë literaturën të 5 viteve të fundit.</p> <p>Ndërkohë referuar vizitës në bibliotekën e institucionit, konstatohet se numri i librave (fizike) është i vogël sidomos në literaturë ndihmëse, ndërkohë që nuk u identifikuan burime alternative si biblioteka dixhitale. Për sa më sipër, GVJ është e mendimit se institucioni duhet të ndërmarrë iniciativa për shtimin e titujve për literaturën bazë dhe ndihmëse, periodikëve, revistave në hard copy, por edhe mundësinë e abonimit në një bibliotekë digjitale.</p> <p>[Anex II 11 Lista e librave te reja sipas programit FE.pdf; Anex III 2.4 Syllabus MP AB.pdf]</p> |
| <p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p> | <p>Referuar <u>Anex II 11 Lista e librave te reja sipas programit FE.pdf</u>, dhe vizitës në institucion, GVJ është e mendimit se biblioteka e institucionit duhet të azhurnohet me titujt e botimeve të fundit, të shtojë numrin e kopjeve në bibliotekë si dhe të ketë një organizim më efektiv si dhe hapësira më komode e motivuese për studentët .</p> |
| <p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p> | <p>GVJ gjatë vizitës në institucion nuk konstatoi ekzistencën e librarive on-line, por stafi akademik i udhezoi studentët të aksesojnë materiale të ndryshme në mbështetje të procesit mësimor.</p> |
| <p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p> | <p>GVJ sugjeron që institucioni të krijojë mundësinë e regjistrimit në një bibliotekë on-line, të aksesueshme së paku në ambientet e institucionit dhe mbi të gjitha në bibliotekë.</p> |
| <p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p> | <p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në funksion të cilësisë së mësimdhënies institucioni ka aktualisht 4 laboratorë: laboratorin e Informatikës, laboratorin e Kontabilitetit, laboratorin e Kimisë dhe Teknologjisë Ushqimore dhe laboratorin e Elektronikës. Nga takimi me studentët konstatohet se studentët mund t'i shfrytëzojnë këto ambiente, në shërbim të detyrave të kursit, temës së diplomës etj.</p> |
| <p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të</p> | |

| brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | <p>Në KUQ përdoret sistemi MOODLE, i cili ofron mundësinë e komunikimit interaktiv mes përdoruesve, stafit akademik, studentëve të programit, por edhe stafit administrativ.</p> <p>Nga informacioni i siguruar nga sekretaria e institucionit, studentët e programit dhe stafi akademik kanë mundësinë që nëpërmjet kredencialeve personale të aksesojnë dokumentacionin elektronik, të uploidojnë/ downloidojnë leksionet, vlerësimet individuale etj.</p> | | | | | | |
|---|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|---|--|--|
| <p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p> | <p>Nga informacioni i siguruar gjatë takimit me stafin akademik, studentët si dhe dokumentacioni i depozituar në sistemin e ASCAL, Departamenti i Menaxhim Biznesit, informon studentët e vitit të fundit, për fushat e studimit dhe tematikat orientuese për tezat e diplomës. Studentët paraqesin kërkesat e tyre në departament për temën e zgjedhur dhe preferencën për udhëheqës.</p> <p>Studenti gjithashtu ka lirinë të propozojë vetë një tezë diplome se bashku me udhëheqesin përkatës. Duke qenë se numri i studentëve është i vogël, krijon mundësinë për të respektuar zgjedhjet e tyre dhe për t'i udhëhequr ata drejt realizimit të punimeve cilësore.</p> <p>[Anex_II_5_RregulloreDepartamentit MB, Neni 49 Anex_III_1_Rregullore e Program_ Studimi_FE_MP_AB; Anex_II_17_Kërkesat për përgatitjen e punimit të Diplomës.pdf]</p> | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="619 1068 775 1155">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="775 1068 999 1155">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="999 1068 1222 1155">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="619 1155 775 1202" style="text-align: center;">✓</td> <td data-bbox="775 1155 999 1202"></td> <td data-bbox="999 1155 1222 1202"></td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | ✓ | | |
| Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| ✓ | | | | | | | |

| <p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p> | |
|---|--|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> | <p>KUQ ka ngritur strukturën e NJSBC, e cila ka funksion kryesor sigurimin e cilësisë së brendshme. Kjo njësi është në nivel institucional, realizon pyetësorët e studentëve, perpunimin dhe analizën e tyre, si dhe harton raportin në nivel institucional, të cilin e paraqet në senat.</p> <p>GVJ konsultoi raportin vjetor për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor i cili konsiderohet një formë që i shërben plotësisht të këtij kriteri, por GVJ është e mendimit se NJSBC duhet të hartojë, në mënyrë të posaçme dhe të detajuar për gjithë aktivitetin e vetë, mekanizmat e përdorur dhe identifikimin e praktikave të mira /problematikave dhe të propozojë/adresojë zgjidhje për to.</p> <p>GVJ është e mendimit se institucioni duhet të përmirësojë ndjeshëm dokumentimin e vazhduar të procesve të realizuara për përmirësimin e cilësisë.</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>[Anex 1.5.1. Rregullore e NJSBC-se.pdf; Anex 1.5.2. Politikat e Vlerësimit të Brendshëm.pdf; Anex 1.5. Manuali i Cilësisë KUQ.pdf]</p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p> <p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p> | <p>Njësia bazë mbështet dhe nxit proceset, të cilat synojnë rritjen e vetëdijes për rëndësinë e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se njësia bazë inicion procese për përmirësimin e e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet trajnimeve të ndryshme.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohen trajnime të realizuara, mbështetur në burime të brendshme/ të jashtme për implementimin e metodave të reja. Zhvillimi i trajnimeve për metodat e mësimdhënies, është tregues i nxitjes së njësisë bazë për përdorimin e metodave të reja, por GVJ sugjeron që këto aktivitete të mos jenë sporadike, të jenë të vazhdueshme dhe të planifikuara dhe strukturat respektive të ndjekin reflektimin e këtyre metodave në proceset mësimore.</p> <p>[Aneks/Shtojcë Vendim për ndryshim plani dhe procesverbal mbledhje, MP dhe Msc Administrim Biznes, Kolegji Universitar Qiriazi, Aneks/Shtojcë Lista e veprimtarive të kolegjit, MP dhe Msc Administrim Biznes, Kolegji Universitar Qiriazi]</p> <p>[Anex 1.18 Sistemi Informatik dhe Metodat e Mesimdhënies.pdf]</p> |
| | <p>Personeli akademik i programit, nisur nga CV e tyre merr pjesë me referime në konferenca shkencore dhe botime në revista shkencore, por GVJ sugjeron planifikimin/ organizimin e aktiviteteve kualifikuese për kërkimin shkencor. Qasja e institucionit për kërkimin shkencor mendojmë se duhet të jetë më proaktive.</p> <p>[Anex III 2.3 CV pedagog MP AB.pdf]</p> <p>[Aneks/Shtojcë Lista e veprimtarive të kolegjit, MP dhe Msc Administrim Biznes, Kolegji Universitar Qiriazi]; Anex 1.18 Sistemi Informatik dhe Metodat e Mesimdhënies.pdf]</p> |
| <p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> | <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se personeli ndihmësakademik, është i angazhuar për të kryer detyrat, por GVJ konstaton mbivendosje të detyrave, për të cilën mendojmë se ndikon jopozitivisht në efektivitetin e tërësisë së proceseve dhe krijon pak hapësirë për suport ndaj metodave innovative.</p> <p>GVJ sugjeron një ndarje më të qartë të detyrave dhe një organizim më funksional</p> |
| <p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p> | <p>Sipas RVB, Përgjegjësit e departamenteve me anë të verifikimeve në auditorët e mësimdhënies apo takimeve specifike, vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies duke raportuar më tej pranë dekanit, por GVJ është e mendimit, se për përmbushjen e këtij kriteri, KUQ duhet të ketë parasysh për të ardhmen, testimin e metodave të reja duke marrë një feed back për pritshmëritë dhe efektivitetin e këtyre metodave, nga stafi akademik, studentët dhe stafi ndihmësakademik me qëllim</p> |

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| | ndërmarrjen e veprimeve rregulluese. | | |
| Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit, lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. | GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se KUQ, angazhon lektorë në procesin mësimor, si lektorë të ftuar apo kërkues shkencorë jashtë institucionit për shkëmbim të ideve dhe eksperiencave. [Anex 1.13 Lista e bashkëpunimit ndër-institucionale Kolegjit.pdf] | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | ✓ | | |

| Standardi III.5 | |
|---|--|
| Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | GVJ konstaton se në dokumentacionin e depozituar nga institucioni, testimit e vlerësimit të njohurive, përcaktohen në rregullore të posaçme si rregullore e fakultetit, departamentit, programit, bëhen publike dhe njihen nga studentët. Kontrolli i dijes për studentët e MPAB, realizohet nëpërmjet vlerësimit gjithësemestral. Skema e vlerësimit në 8 prej lëndëve është 50 pikë vlerësimi semestral dhe 50 pikë provimi përfundimtar, ndërsa një lëndë ka vlerësimin, 40 pikë vlerësimi semestral dhe 60 pikë provimi përfundimtar. GVJ është e mendimit se këto skema vlerësimi krijojnë mundësi të nxitjes dhe aktivizimit të studentëve gjatë gjithë semestrit, duke përdorur forma alternative vlerësimi të përshtatshme për një mjedis heterogjen studentësh në funksion të formësimit dhe përvetësimit të dijeve të qëndrueshme. [Anex II.1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf] [Anex II.5 Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit.pdf] [Anex III.1 Rregullore e Program Studim FE MP Admin Biznes.pdf] |
| Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | GVJ konstaton nga takimi me studentët dhe stafin akademik se ata informohen nga stafi akademik në fillim të semestrit për, programin e lëndës, format alternative të vlerësimit, dhe detyrimet që studentët kanë. |
| Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Referuar rregullores së programit, syllabuseve dhe informacionit të siguruar nga stafi akademik dhe studentët, rezulton se në syllabus janë parashikuar format e vlerësimit, masa e vlerësimit të çdo komponenti. Këto forma janë alternative dhe të diversifikuara duke iu dhënë mundësi të gjithë studentëve, të demonstrojnë njohuritë e përfituara. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | ✓ |

| Standardi III.6 | |
|--|---|
| Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> | <p>GVJ referuar burimeve alternative, syllabuseve, stafit akademik dhe studentëve, konkludon se vlerësimi është gjithë semestral, me komponente të tillë si detyra individuale, detyra kursi, mid term dhe provimi final. Të gjithë komponentët reflektohen në vlerësimin final.</p> <p>Në disa prej lëndëve studentët bëjnë testime on-line nëpërmjet platformave elektronike.</p> <p>Ndërkohë GVJ sugjeron edhe forma alternative të testuara për vlerësimin, si clean score etj.</p> |
| <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p> <p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p> <p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>Nga komunikimi me stafin akademik dhe drejtuesin e njësisë bazë, rezultojnë se testimi përfundimtar realizohet nga një komision, i cili rezultojnë se ka jo më pak se 2 anëtarë, këto komisione miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Në komision njëri nga anëtarët është titullari i lëndës. Pavarësisht kësaj, institucioni nuk vendosi në dispozicion të GVJ, dokumentacion për të vërtetuar se kjo praktikë ndiqet</p> <p>GVJ konstaton se studentët monitorohen nga komisioni gjatë gjithë provimit, për të siguruar kushtet e zhvillimit korrekt. Provimet realizohen të sekretuara, dhe realizohen nga sekretaria, për të ruajtur anonimitetin e studentëve.</p> <p>Gjithashtu rezultojnë se studentët kanë të drejtë të marrin feedback dhe të konsultojnë vlerësimin e tezave të tyre, si mundësi për përmirësimin e rezultatit të tyre në të ardhmen</p> |
| <p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p> | <p>Provimet zhvillohen me mbikëqyrje nga komisioni për të shmangur kopjimin, ndërkohë për plagjiaturën ende nuk ka një program. Sugjerohet që KUQ të investojë në sigurimin e një program antiplagjaturë.</p> |
| <p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> | <p>Studentët e PS MPAB, rezultojnë se vlerësimet i marrin në kohën e përcaktuar sipas rregullores. Në seancën e fundit mësimore studentët informohen për vlerësimin gjatë semestrit. Këto vlerësime janë komponentë të vlerësimit final. Rezultatet duhet të nxirren brenda 10 ditëve kalendarike, që nga data e zhvillimit të provimit. Studentët i akcsojnë rezultatet /vlerësimet e tyre nëpërmjet sistemit. Nga takimi me studentët për GVJ, rezultojnë se perceptimi i tyre ishte për vlerësim mbi bazë të meritës.</p> |
| <p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në</p> | <p>Referuar dokumentacionit të depozituar të KUQ por edhe takimeve me studentët e programit, studenti ka të sanksionuar të</p> |

| <p>përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p> | <p>drejtën për tu njohur me vlerësimin, me menyrën e korigjimit, për të qenë i qartë për gabimet/mungesat në përgjigje dhe për vlerësimin sipas meritës.</p> <p>GVJ konstaton në dokumentacionin e depozituar të KUQ, si rregullore institucioni, fakulteti, programi, studenti ka të sanksionuar të drejtën e ankimimit për rezultatet. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahen në dekanat.</p> <p>[Anex III.1 Rregullore e Program Studiu FE MP Admin Biznes.pdf]</p> | | | | | | | | |
|---|---|-----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 616 762 705">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="762 616 986 705">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="986 616 1209 705">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1209 616 1410 705">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | ✓ |
| Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | ✓ | | | | | | |

| Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore. | |
|--|---|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> | <p>Referuar informacionit të siguruar nga takimet me studentët dhe stafin akademik, rezulton se metodat e përdorura, janë në funksion të thellimit të njohurive të studentëve; në leksione dhe seminare, synohet aktivizimi i studentëve, nëpërmjet rasteve studimore, detyrave të grupit, detyrave të kursit, për të zhvilluar aftësitë profesionale të studentëve.</p> <p>Programi i studimit përmban lëndë të tilla si Manaxhimi i Sistemeve të Informacionit, e cila ndihmon në zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve, në fushën e teknologjisë së informacionit</p> |
| <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p> | <p>Nga takimi me studentët e programit MPAB, në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Nëpërmjet pyetësorëve të realizuar në fund të semestrit, sigurohet informacion i përgjithshëm për cilësinë e aftësive që ata fitojnë, por GVJ sugjeron përfshirjen në pyetësorët e studentëve, edhe të pyetjeve specifike rreth kompetencave të fituara nga studentët për të siguruar informacion rreth realizimit të objektivave</p> |
| <p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p> | <p>Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit si dhe nga pedagogët, në seancën e fundit të semestrit cdo pedagog realizon një përmbledhje të lëndës, temave kryesore dhe orienton studentët rreth testit përfundimtar, dhe adreson paqartësitë që studentët kanë.</p> |
| <p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë</p> | <p>GVJ konstaton nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, se studentët e programit MPAB, kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat ata informohen rreth inovacioneve dhe arritjeve të shkencës, sic është seminari me temë</p> |

| | | | | |
|---|---|--------------------------------|---------------------------------|----------|
| strukturës së programit të studimit. | Arsimi dhe kërkimi shencor në bashkëpunim me Zyrën e Erasmusit. [Aneks/Shtojce Lista e veprimtarive të kolegjit, MP dhe Msc Administrim Biznes, Kolegji Universitar Qiriazi] | | | |
| <p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p> <p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p> <p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p> <p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p> | <p>Referuar PS në MPAB dhe syllabuseve si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, rezulton se në procesin e mësimdhënies organizimi i orës së mësimi i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale, zhvillim kompetencash si dhe aplikim i njohurive të siguruara nga teoria.</p> <p>Referuar syllabuseve të lëndëve dhe informacionit në takimet me studentët dhe me stafin e programit, GVJ konstaton se pedagogët inkurajojnë studentët të përfshihen në aktivitete dhe detyra grupi për adresimin e problemeve në të cilat ndeshen bizneset në aspektin manaxherial dhe jo vetëm. Për këtë studentëve ju shpërndahen raste studimore të situatave komplekse të biznesit. Pavarësisht mbështetjes dhe suportit të studentëve, duke qenë se numri i studentëve është shumë i vogël, mbetet e vështirë organizimi i detyrave të grupit dhe nxitja e diskutimeve dhe debateve nga kenveshtrime të ndryshme</p> <p>GVJ është i mendimit se gjatë procesit mësimor, personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit, por institucioni duhet të suportojë duke krijuar mundësinë e krijimit të inkubatorëve të biznesit si dhe të nxisë pjesëmarrjen e studentëve në projekte kërkimore.</p> <p>Pavarësisht mbështetjes së stafit për përfshirjen e studentëve, roli kryesor duhet të jetë i institucionit, i cili duhet të sigurojë informacionin për alternativat e përfshirjes, motivimin dhe mbështetjen financiare për studentët. GVJ nga vizita në institucion nuk siguroi asnjë praktikë të përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor</p> | | | |
| <p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p> | <p>Gvj konstaton bashkëpunime mes KUQ dhe institucioneve të ndryshme, të cilat synojnë përfshirjen e studentëve në intershipe, për të rritur mundësinë e punësimit të tyre. [Aneks/Shtojce Lista e bashkëpunimit rezultative në aktivitete, MP dhe Msc Administrim Biznes, Kolegji Universitar Qiriazi]</p> <p>Nga takimi me stafin akademik, stafi i mentoron studentët në praktikë, për të orientuar ata të aplikojnë njohuritë teorike të marra në auditor, në mjedise reale biznesi.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbljes së standardit</p> | <p>Përmbljes pjesërisht</p> | <p>Përmbljes kryesisht</p> | <p>Përmbljes plotësisht</p> | <p>✓</p> |

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | | | | |
|--|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|
| Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Nga sa rezultoi nga vizita në institucion si dhe nga takimet me studentët e PS MPAB, kryesisht praktikat profesionale zhvillohen në mjedise jashtë fakultetit kryesisht pranë bizneseve me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi ose në biznese që studentët I kanë siguruar individualisht me miratimin e institucionit. Përsa i përket praktikave laboratorike në lëndë të caktuara si Sisteme të informacionit të manaxhimit, ato zhvillohen në mjediset e institucionit, në laboratorin e teknologjisë informative, i cili disponon infrastrukturën dhe kapacitetin e duhur të posteve për të zhvilluar procese normale. [Anex I 11.7 Statistike per mjediset e KUQ.pdf] | | | | | | |
| Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | GVJ konstatoi se insitucioni për praktikave profesionale në programin MPAB ka vendosur lidhje bashkëpunimi me një numër institucionesh dhe subjektsh private që plotesojnë kushtet e kërkuara nga natyra e e PS MPAB, për të qënë vend zhvillimi i praktikave. Përveç infrastrukturës materiale që ofrojnë subjektet ku realizohen praktikat mësimore ata angazhojnë edhe mentorues që në bashkëpunim me pedagogët dhe procedurat e vlerësimit të praktikave sipas rregullores së programit, te realizojnë qellimin e tyre. [Anex III 4 Rregullore e Praktikës Profesionale për FE.pdf] [Anex I 13 Lista e bashkëpunimit ndërinstitucionale Kolegjil.pdf] | | | | | | |
| Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Referuar planit mësimor të PS MPAB, praktika profesionale është 40 orë në auditor dhe 60 orë punë e pavarur e studentit. Praktika profesionale ka 4 kredite dhe nuk vlerësohet me notë, por me statusin 'Fiton' ose "Nuk fiton". Kjo praktikë rezultoi të dokumentohet dhe studentit para mbrojtjes së saj para komisionit duhet të depozitohet vërtetimin e zhvillimit të praktikës si dhe relacionin e praktikës. Duke qënë se praktika ka në fokus aplikimin e njohurive teorike të marra nga studentët, sugjerohet rishikim i ndarjes orë në auditor/punë e pavarur, duke rritur orët në praktikë dhe duke ulur orët e punës së pavarur. [Anex II 8 Rregullore e praktikës profesionale; Anex III 2 Dosja e programit të studimit; Anex III 1 Rregullore e programit të studimit] | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>✓</td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | ✓ |
| Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | | ✓ | | | | | |

Standardi III.9

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Referuar rregullores së PS MPAB dhe të fakultetit të Ekonomisë, rezultoi se KUQ, harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve si më |

| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> <p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p> | <p>poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pranë KUQ, me fillimin e semestrit të fundit të programit MPAB, hartohet individualisht nga cdo student në bashkëpunim me drejtuesin e zgjedhur prej tij, një plan diplomimi i cili përcakton periudhat kohore dhe angazhimet e duhura për diplomimin. - Udhëheqësi përcakton dhe grafikun e konsultimeve të programuara për cdo student, grafik i cili është i detyrueshëm të zbatohet nga te dyja palet. <p>Nga takimi në institucion me studentët, rezulton se ata janë informuar nga strukturat përgjegjëse dhe nga udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final të mbrojtjes së diplomës.</p> <p>GVJ konstaton se, studentët kanë provim final, mbrojtjen e punimit të diplomës para Komisionit të posaçëm, e cila synon integrimin e të gjithë njohurive të marra gjatë studimeve master në një fushë/temë të caktuar.</p> <p>Referuar rregullores si dhe takimit me studentët dhe stafin akademik të programit, departamenti bën të njohura për studentët temat ose fushat e studimit për përgatitjen e punimeve të diplomave. Studentët paraqesin kërkesat e tyre në departament për temën e zgjedhur dhe preferencën për udhëheqës. Departamenti i shqyrton ato dhe cakton udhëheqësit nisur nga specialiteti dhe kualifikimi i personelit akademik të tij, duke qenë se janë numër i vogël studentësh, preferencat e tyre përgjithësisht merren parasysh.</p> <p>[Anex II 1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Anex II 5 Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesi, [Anex III 2 1 Program i studimit MP Administrim Biznesi.pdf] Anex 1 2 Rregullore e KUQ]</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> <p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> | <p>GVJ është e mendimit se fusha manaxheriale ku përgjithësisht janë mundësitë për realizimin e temave të diplomës, kërkon hulumtime empirike në terren dhe jashtë ambienteve të KUQ, por institucioni ka kapacitete për ti asistuar studentët në përpunimet statistikore kompjuterike që mund të realizojnë.</p> <p>Stafi akademik ka të planifikuar disa seanca sipas një plani, për të asistuar studentët, për strukturën e punimit, metodologjinë, instrumentët e përdorur, përpunimin e tyre si dhe mënyrën e shkrimit.</p> <p>Pedagogu udhëheqës, para paraqitjes së punimit para komisionit të diplomës, duhet të nënshkruajë lejen për paraqitjen e punimit në komision, nëpërmjet të cilës certifikon se punimi plotëson kushtet.</p> <p>[Anex III 2 1 Program i studimit MP Administrim Biznesi.pdf]</p> |
| <p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p> | <p>Referuar rregullores së PS MPAB dhe të fakultetit të Ekonomisë, Komisioni mbas paraqitjes së punimit, mbështetur në vlerësimin e udhëheqësit, si dhe përgjigjet e studentit për pyetjet e bëra e</p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> | <p>vlerëson studentin me notë.</p> <p>Ashtu sic është e parashikuar në rregullore, studenti ka të drejtë të tërheqë diplomën si dhe suplementin mbas diplomimit, modelet e të cilave jepen në shtojcë.</p> <p>Referuar modeleve të diplomës në shtojcë, konstatohet se ajo mban titullin në përputhje me emërtimin e programit, gjeneralitet si studentit, numrin e matrikullimit, numrin e diplomes se lëshuar, e nënshkruar nga Rektori dhe Dekani, etj.</p> <p>[Anex III 3 2 Diplome MP Administrim Biznesit Anex III 3 2 1 Model Suplement Diplome]</p> | | | |
| <p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p> | <p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, student më kërkues të tij, ka të drejtën të pajiset me dokumentacionin e plotë rreth programit të studimit, si plan mësimor, syllabuse, vertetim notash etj. Pas mbarimit të studimeve dhe pajisjes me diplomë, dokumentet dorëzohen në protokoll – arkiv. Procedurat për ruajtjen dhe hyrje/daljet e dokumentacioneve janë të paraqitura në ‘Rregulloren për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit’.</p> <p>Dosjet e studentëve të vëna në dispozicion të GVJ gjatë takimit, rezultuan se kishin informacion të plotë, si deklaratën personale, diploma dhe listë notash të shkollës së mesme të noterizuar, diploma dhe listë notash të bachelorit të noterizuar, fotografi personale.</p> <p>[Anex II 1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf; Anex II 5 Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit.pdf]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

| | | | | |
|--|------------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
|--|------------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| | |
|--|--|
| <p>Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo</p> | <p>GVJ konstatoi se KUQ, në lidhje me PS MPAB, disponon të dhënat për çdo semestër, për çdo vit akademik, të stafit akademik që përfshihet në program. Në këto të dhëna përcaktohen edhe lëndët që mbulon secili anëtar i stafit akademik si dhe statusin e tij, PAE apo PAK. Personi përgjegjës për organizimin e programit të studimit PS MPAB, është përgjegjës i</p> |

| | |
|---|---|
| <p>anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p> | <p>departamentit të Manaxhim Biznesit, i cili ka gradën shkencore” Doktor i Shkencave”</p> <p>Nga konsultimi i dosjeve të stafit të programit, rezultojnë se në dosjet e perzgjedhura në mënyrë rastësore gjenden dokumentacioni si, librezë pune, kontratë e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktoratës, CV, etj</p> <p><i>[Aneksi/Shtojcë Ngarkesa mësimore në MP në Administrim Biznesi, Kolegji Universitar Qiriaci: Anex III 2.5 Të Dhenat e Stafit Akademik MP Administrim Biznesi.pdf]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedurën për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë harton procedurën e kritereve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedurën rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulin dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>Referuar informacionit të konsultuar në sistemin AMS të ASCAL, rezultojnë se KUQ, ka një tërësi rregulloresh dhe dokumentesh të mbështetur në bazën ligjore në lidhje me procedurat e rekrutimit të stafit akademik si: Rregullore e zyrës së burimeve njerëzore, Kriteret e vlerësimit për punë si staf akademik, Formular Aplikimi për Staf Akademik, ndërkohë GJV gjatë vizitës në institucion me stafin e burimeve njerëzore, nuk siguroi një praktikë konkrete, të zbatimit të këtyre procedurave të sanksionuar në aktet rregullatore të KUQ.</p> <p>Stafi i burimeve njerëzore shprehet se ata zbatojnë rregulloret, përzgjidhen më të mirët, por pranojnë që këto procedura nuk i kanë të dokumentuara dhe nuk kanë referencat dokumentare që deshmojnë procesin e rekrutimit, kështu që edhe GJV nuk mund të shprehet, pa pasur praktikën e rekrutimeve për stafin akademik të Programit master profesional në Administrim Biznesi.</p> <p>GJV referuar dokumentacionit të depozituar në sistemin AMS, konstaton se KUQ ka hartuar një procedurë në të cilën identifikohen, kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin e personelit, por GJV nuk mundi të verifikonte sesi këto procedura aplikoheshin, kush aplikonte, si bëhej vlerësimi i tyre dhe si përzgjidhej apo nëse bëheshin publike këto procedura GJV nuk konstatoi mekanizma të bërjes publike të këtyre kritereve</p> <p>GJV është e mendimit se institucioni duhet të standardizojë, të formalizojë dhe të dokumentojë procesin e rekrutimit të stafit akademik dhe atij administrativ.</p> <p>GJV vlerëson faktin që KUQ ka dokumenta rregullatore, rregullore të burimeve njerëzore, kritere të përgjithshme dhe specifike si dhe procedurën e vlerësimit të kandidatëve për të përzgjedhur aplikantët më të mirë. Ndërkohë GJV vëren mungesën e dokumentimit formal, sesi institucioni i ka zbatuar këto procedura rekrutimi të sanksionuara. Në këto kushte GJV nuk mund të vlerësojë sesi këto procedura janë zbatuar, që prej publikimit të njoftimit për rekrutim, tek hartimi i listës së aplikantëve, tek vlerësimi i çdo aplikanti dhe deri tek rekrutimi, për stafin akademik të PS MPAB.</p> |

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>GVJ e konsideron domosdoshmëri jo vetëm zbatimin e këtyre procedurave, por dhe dokumentimin e tyre formal dhe të detajuar të gjithë procedurës së rekrutimit, sikurse aktet rregullatore të institucionit e parashikojnë.</p> <p>[Anex 1.7 Rregullore e zyrës së burimeve njerzore.pdf] [Anex 1.7.3 Kriteret e vlerësimit për punë si staf akademik.pdf] [Anex 1.7.4 Formular Aplikimi për Staf Akademik.pdf] [Anex/Shtojcë Kriteret e vlerësimit për staf akademik]</p> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | ✓ | | |

| Standardi IV.2 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p> | <p>Referuar vizitës në institucion, takimeve me grupe të ndryshme të stafëve, konstaton se KUQ angazhohet për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për personelin, por pavarësisht kësaj mbivendosjet e detyrave dhe mbingarkesa e stafit është e evidente duke ndikuar negativisht në profesionalizmin e kryerjes së detyrave si dhe në mungesën e ruajtjes dhe të dokumentimit të procedurave voluminoze që stafi proceson. GVJ rekomandon rritje të numrit të stafit akademik dhe atij administrativ, përcaktim të përshkrimit të punës si dhe ndarje më funksionale të detyrave</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p> | <p>KUQ rezulton se mbështet stafin e tij për kualifikim të mëtejshëm, në lidhje me metodat inovative, pjesëmarrjen në konferencat që KUQ organizon, duke ndjekur politikën e pjesëmarrjes pa pagesë për ta. Ndërkohë GVJ sugjeron politika më proaktive mbështetje, vendosjen e sistemeve motivuese e stimuluese të pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare prestigjioze apo botimet në revista shkencore prestigjioze të fushës së ekonomisë</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p> | <p>Nga takimet me stafin akademik të PS MPAB, rezulton se KUQ, organizon trajnime/ ose leksione të hapura për metodat inovative të mësimdhënies, të organizuar nga stafi akademik i KUQ.</p> <p>Në nivel KUQ-së ka një udhëzues të veçantë për kualifikimin e stafit akademik, që kanë të bëjnë me metodat e reja në procesin e mësimdhënies dhe kualifikimit profesional të personelit akademik. Në faqen e internetit të institucionit pasqyrohen aktivtete që shërbejnë për nxitjen dhe inkurajimin e punës në të ardhmen. Platformën "E-learning", e cila është një metodë inovative ku i krijon mundësi për të komunikuar me studentët për aspekte të ndryshme të procesit mësimor kërkimor, përfshin të gjitha format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimi, ku materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike.</p> <p>[Anex 1.1.3 Metoda inovative të mësimdhënies]</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë. | KUQ dëshmon për një angazhim të burimeve njerëzore, kryesisht stafit akademik për përmbushjen e objektivave të PS MPAB. Ndërkohë për stafin ndihmësakademik dhe atë administrativ, vihet re mbivendosje të detyrave dhe lind nevoja për një riorganizim dhe ndarje detyrash më specifike, si dhe trajnim i tyre për zbatimin e procedurave, sipas bazës ligjore dhe dokumentimin formal të tyre. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | ✓ | | |

| Standardi IV.3 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave në sistemin AMS për infrastrukturën e KUQ [<i>Raporti i vlerësimit, Relacioni i ambienteve të KUQ; Statistika e mjediseve të KUQ Aneksë</i>], GVJ konstaton se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimin të programit Master i Profesional në “Administrim Biznesi”. Nga këto statistika identifikohet se KUQ, disponon 6 auditorë mësimorë që kanë kapacitet prej 100 -120 vende të ulura në një sipërfaqe prej mëse 100-110 metër katror secila; pesëmbëdhjetë (15) sallat e seminareve, kanë kapacitet prej 30-45 vende ulëse, me një sipërfaqe prej 35-55 metër katror secila. KUQ është një ndërtesë tre kateshe, në qendër të Kampusit të UBT, në Kodër Kamëz, në zonë të gjelbëruar. |
| Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor të PS MPAB, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme, poste ulje, tavolina, pod lekturimi, white bord, videoprojektor. Institucioni duhet të realizojë edhe mbulimin e vazhdueshëm me internet të këtyre hapësirave, si domosdoshmëri për përdorimin e teknologjive të informacionit si dhe metodave alternative të mësimdhënies. |
| Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në funksion të cilësisë së mësimdhënies institucioni ka aktualisht 4 laboratorë: laboratorin e Informatikës, laboratorin e Kontabilitetit, laboratorin e Kimisë dhe Teknologjisë Ushqimore dhe laboratorin e Elektronikës. Nga takimi me studentët konstatohet se studentët mund të shfrytëzojnë këto ambiente, në shërbim të detyrave të kursit, temës së diplomës dhe të objektivave të PS MPAB. |
| Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas | Gjatë vizitës në institucion të GVJ, ndër laboratorët që KUQ |

| <p>natyrës së programit/ëve të studimit që ofron.</p> | <p>disponon, njëri prej tyre rezultoi laboartori i Informatikës, i cili ka pajisjet e duhura hardwerike dhe softwerike që studentëve ju nevojiten. Një ndër laboratorët në shërbim të studentëve rezultoi të jetë edhe Laboratori i Kontabilitetit, në shërbim të studentëve për aftësimin e tyre në programet kompjuterike të mbajtjes së finacave dhe kontabilitetit të njësive ekonomike.</p> <p><i>[Statistika e mjediseve të KUQ; Shënime gjatë vizitës në KUQ]</i></p> | | | | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|---|--|
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p> | <p>Në lëndën e Sistemeve të Informacioni të Manaxhimit, studentët kanë mundësi që të zhvillojnë aktivitete praktike në laboratorët që vetë institucioni posedon dhe që GVJ konstaton se kanë kapacitete pritëse të mjaftueshme Ndërkohë praktika profesionale zhvillohet pranë bizneseve me të cilat KUQ ka marreveshje.</p> <p><i>[Statistika e mjediseve të KUQ].</i></p> <p><i>[Anex 1.13 Lista e bashkëpunimit ndërinstitucionale Kolegjit.pdf]</i></p> | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 750 758 817">Përmbyshet pjesërisht</th> <th data-bbox="758 750 989 817">Përmbyshet kryesisht</th> <th data-bbox="989 750 1220 817">Përmbyshet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="598 817 758 873"></td> <td data-bbox="758 817 989 873" style="text-align: center;">✓</td> <td data-bbox="989 817 1220 873"></td> </tr> </tbody> </table> | Përmbyshet pjesërisht | Përmbyshet kryesisht | Përmbyshet plotësisht | | ✓ | |
| Përmbyshet pjesërisht | Përmbyshet kryesisht | Përmbyshet plotësisht | | | | | |
| | ✓ | | | | | | |

| <p>Standardi IV.4</p> | |
|--|---|
| <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimxënies për studentët e programit të studimit.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p> | <p>KUQ vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore. Në mënyrë që të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të studentëve dhe mundësitë barabartë për të gjithë studentët pavarësisht se PS MPAB, ka numër të vogël studentësh. GVJ sugjeron zgjerim të hapësirës së bibliotekës dhe përmirësim të kushteve të saj infrastrukturale, numer fizik postesh, vendosje te PC, kushte ngrohje/ftohje, për të qenë një mjedis më funksional.</p> <p>Gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstatoi një fond librash fizike, periodike, revista në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj për fushën ekonomisë.</p> <p>Pavarësisht këtij fondi ekzistues, KUQ duhet të zgjerojë fondin e bibliotekës me nje gamë më të gjerë librash, revistash, literaturë bashkohore për programin e studimit PS në MPAB</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se nga departamenti dhe nga fakulteti behen propozimet e përgjithshme për shtimin e fondit të bibliotekës me tituj të literaturës bashkekohore. GVJ nuk siguroi të dhëna mbi buxhetin e parashikuar për blerjen e librave, apo për vendimet e marra nga bordi i administrimit mbi propozimet e njësive respektive.</p> <p>GVJ rekomandon zbatimin e një plani të detajuar të përvitshëm, me propozim nga njësia bazë, për shtimin e fondit të bibliotekës dhe për pasurimin cilësor të saj më literaturë bashkekohore për fushën</p> |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>ekonomisë në përgjithësi e për PS MPAB në vecanti.</p> <p><i>[Aneksi/Shtojca Raporti i buxhetit 2017-2018, Vendum i bordit për shpenzimet e punës shkencore e blerjen e librave për bibliotekën]</i></p> <p><i>[Anex II.11. Lista e re e Librave të FE]</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> | <p>Pavarësisht se pedagogët e programit të studimit ju rekomandojnë studentëve leximin e artikujve të ndryshëm në internet, GVJ referuar vizitës në bibliotekë, sugjeron pajisjen e saj me kompjutera, me internet, me mundësinë e aksesimit elektronik të një data base librash/revistash për të qenë një ambient që fton e mirëpret studentët e PS në MPAB dhe jo vetëm.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi prezencën e librave dhe literaturës ndihmëse fizike. GVJ sugjeron pajisjen me disa PC të bibliotekës me mundësinë e shfrytëzimit të tyre nga studentët, me programe kompjuterike që inventarizojnë bazën e librave që KUQ disponon, apo që sigurojnë informacion mbi kërkimet elektronike të studentëve për literaturë si dhe të pajisjeve të tjera elektronike, skaner, 'all in one', printer, fotokopje etj, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve</p> | | | |
| <p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p> | <p>GVJ konstaton se orari i bibliotekës, është në përputhje me orarin e zhvillimit të PS MPAB. Orari i saj është i deklaruar në hyrje të saj dhe është nga e hëna në të premte, 8.00 – 18.00.</p> <p>GVJ sugjeron pajisjen e studentëve të MPAB me kartela rregjistrimi, pasi gjatë vizitës në institucion këto kartela për këtë program nuk ishin plotësuar</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbyshet plotësisht | Përmbyshet pjesërisht | Përmbyshet kryesisht | Përmbyshet plotësisht |
| | | ✓ | | |

| | |
|---|--|
| Standardi IV.5 | |
| Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e</p> | <p>GVJ referuar rregullores së KUQ, konstaton se të dhënat në KUQ mbahen në dy forma, regjistrat manualë dhe regjistrat elektronik. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit, por GVJ nuk konstatoi një sistem informacioni funksional, që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në PS MPAB i cili të jetë pjesë e një sistemi të integruar informacioni në nivel institucional.</p> <p>Referuar takimit të zhvilluar me stafin e burimeve njerëzore, rezultoi se zyra e burimeve njerëzore administrohet të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrative. Këto të dhëna</p> |

| | | | |
|---|---|-----------------------------|------------------------------|
| <p>dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>rezultuan të jenë kryesisht manuale.</p> <p>Referuar takimit me studentët, rezulton se studentët nëpërmjet kredencialeve të tyre personale, kanë akses në informacionin në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respektive.</p> <p>GVJ sugjeron implementimin e një sistemi informacioni të integruar në KUQ, ku një prej moduleve të tij të jetë për manaxhimin e gjithë data bazës në vite për stafin akademik, ndihmësakademik, personelit administrative, duke nisur që prej procedurave të konurimit, seleskionit, rekrutimit, ndryshimet vit mbas viti etj.</p> | | |
| <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> | <p>Referuar RVB por edhe takimeve me studentët e programit si dhe stafin akademik të përfshirë, rezulton se në institucion, për komunikimin interaktiv të stafit akademik me studentët përdoret LMS (Learning management system) që janë aplikacione në web, të cilat mundësojnë menaxhimin e materialit mësimor dhe administrimin e procesit mësimor. Një prej tyre është MOODLE e cila është përpunuar duke iu përshtatur strukturës së Kolegjit Universitar Qiriazi dhe është quajtur E-Learning. [www.qiriazi.edu.al platforma e-learning]</p> <p>Duke qenë se numri i stafit akademik, joakademik dhe i studentëve është i vogël, deri tani manaxhimi arrin të monitorojë aktivitetin akademik e administrativ, por GVJ rekomandon implementimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të informacionit, i cili garanton monitorim dhe siguron raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese, titullarët apo ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë institucioni do të siguronte një dokumentim dhe formalizim më të mirë të proceseve administrative, për të dëshmuar dhe gjurmuar proceset e realizuara, problem që u identifikua gjatë vizitës në institucion.</p> | | |
| <p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p> | <p>GVJ konstatoi se webi i institucionit është funksional, ai është dy gjuhësh, shqip dhe anglisht. Në web GVJ konstatoi të dhëna, rreth fakultetit, departamentit, programeve të studimit syllabuseve etj. [www.qiriazi.edu.al]</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

| <p>Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p> | |
|---|--|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen</p> | <p>GVJ referuar RVB dhe vizitës në institucion konstaton se është Bordi i Administrimit që përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron KUQ nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si</p> |

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| <p>e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> <p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjedisëve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzime për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p> | <p>edhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit. Bordi i Administrimit siguron qëndrueshmërinë financiare në Institucion, ku si pjesë të planit të tij financiar ka buxhetimin e të ardhurave dhe alokimin e tyre. KUQ harton një raport financiar, ku jepet informacion rreth kostove për MPAB. <i>[Anex/Shtojce Raporti i buxhetit 2017-2018; Anex II 3 Plani vjetor i KUQ].</i></p> <p>GVJ rekomandon që në planin për mbështetjen financiare të ketë aktivitete më të detajuara të planifikuara për mbarëvajtjen e PS MPAB, për të paktën një cikël të plotë studimi., ashtu sikundër kërkohet në kriterin 1</p> <p>Referuar planit të financimit të depozituar në sistemin AMS, GVJ konstaton se ky plan financimi duhet të jetë më i detajuar dhe të ofrojë informacion mbi elementët sipas kriterit 2, në nivel programor.</p> <p><i>[Anex 1 16 Plani financiar për menaxhimin me efektivitet të institucionit]</i></p> | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> | <p>GVJ referuar RVB, konstaton se çdo vit institucioni kryen auditim nga një kompani e certifikuar. Raporti i auditit të jashtëm fokusohet në kërkesat ligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ai jep opinionin e tij të pavarur mbi situatën financiare të Kolegjit. Përveç auditimit të jashtëm KUQ kryen dhe auditime të brendshme dhe i raporton në Bordin e Administrimit.</p> <p><i>[Anex 1 15 Raporti vjetor 2017-2018; Anex 1 5 2 Politikat e vleresimit të brendshëm; Anex 1 20 PASQYRAT FINANCIARE KUQ 2018.pdf]</i></p> | | |
| <p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> | <p>GVJ konstaton në sistemin AMS se institucioni ka depozituar raportet vjetore të 2017-2018 dhe të 2016-2017 si dhe planin financiar të 2017-2018, por nuk konstatoi raporte financiare për 3 vitet e shkuara sikundër kriteri 4 kërkon, prandaj GVJ nuk mund të shprehet për këto kriter</p> <p><i>[Anex 1 15 Raporti vjetor 2017-2018; Anex 1 5 2 Politikat e vleresimit të brendshëm]</i></p> | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p> | <p>GVJ nëpërmjet sistemit AMS, konstatoi se strukturat përkatëse hartojnë pasqyrat financiare vjetore, të cilat sipas RVB dhe takimit me GVB, raportohen në senat dhe në bordin e Administrimit dhe miratohen nga ekspertët të jashtëm.</p> <p>GVJ referuar numrit të vogël të të regjistruarve në MPAB, cka deshmon për të ardhura shumë të ulta nga të ardhurat e studentëve, rekomandon gjetjen e mekanizmave për rritjen e numrit të studentëve dhe të të ardhurave për këtë program, për të rritur qëndrueshmërinë financiare në të ardhmen</p> <p><i>[Anex 1 20 PASQYRAT FINANCIARE KUQ 2018.pdf]</i></p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

| | | | | |
|---|------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Përmbushet | Përmbushet pjesësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | ✓ | | |

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Standardi V.1 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Ka një sërë rregulloresh dhe procedurash duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit. Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis nga momenti i informimit për programet akademike për maturantët dhe deri pas përfundimit të studimeve nga ana e tyre. Kolegji pajis studentët me të gjithë materialct e nevojshme të informimit si broshura, fletpalosje, i adreson në faqen ëeb dhe i informon në lidhje me çdo mjet tjetër komunikimi.</p> <p>Rekomandohet që për secilën nga zyrat që shoqëron studentin nga hyrja në dalje, pra nga sekretaria sekretaria mësimore deri te zyra e marrëdhënieve me jashtë, pranimeve dhe këshillimit të karrierës të dokumentojnë aktivitetet. Psh kur institucioni deklaron që ka zhvilluar open days në kuadër të informimit dhe këshillimit të karrierës duhet ta dokumentojë atë më një listë pjesëmarrësish dhe foto në faqen online të Universitetit. Pasurimi me praktika për çdo zyrë përgjegjëse në kontaktin me studentin do të ndihmojë për të rritur cilësinë shërbimit në të ardhmen. Ato nuk figurojnë në listën e dokumentave të paraqitura për vlerësim.</p> <p>Institucioni paraqet që në ciklin e dytë të studimeve MPAB, i jepet e drejta çdo studenti, pa dallim, i cili ka mbaruar studimet ne nivelin Bachelor. Ky është kriter i cili duhet plotësuar. Politikat dhe procedurat e kolegjit, nuk përmbajnë asnje kriter tjetër skualifikimi, të gjithë studentët kanë të drejtën e aplikimit dhe kanë të drejta të barabarta.</p> <p><i>Anex 1.3 Rregullore e KUQ;</i> <i>Anex 1.9 Rregullore e Sekretarisë mësimore;</i> <i>Anex 1.18 Faqja e internetit të KUQ;</i> <i>Anex 11 Rregullore e diplomimit</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga</p> | <p>Kriteri plotësohet, institucioni vë në dispozicion të informimit, një sërë burimesh si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▫ faqen e webit; ▫ portalin SMS, (Sistemi i Menaxhimit te Studentit, “E-learning”). |

| publiku. | <ul style="list-style-type: none"> ▫ struktura përgjegjëse si departamenti, ▫ zyra e këshillimit të karrierës, <p>Nëpërmjet këtyre zyrave studentët informohen për: procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit për gjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve.</p> <p><i>Ref. www.qiriazi.edu.al</i> <i>Anex. II.1. Rregullorë FE;</i> <i>Anex. I.9 Rregullorë e Sekretarisë mësimore</i> <i>Anex. I.18 Sistemi informutik dhe metodat e mesimdhënies</i></p> | | | | | | |
|--|--|----------------------|---------------------|----------------------|--|---|--|
| Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. | <p>Institucioni paraqet që në ciklin e dytë të studimeve MPAB, i jepet e drejta çdo studenti, pa dallim, i cili ka mbaruar studimet ne nivelin Bachelor. Politikat dhe procedurat e kolegjit, nuk përmbajnë asnjë kriter tjetër skualifikimi, të gjithë studentët kanë të drejtën e aplikimit dhe kanë të drejta të barabarta.</p> <p><i>Anex. I.3 Rregullorë e KUQ;</i> <i>Anex. I.14 Kriteret e pranimit të studentëve në Kolegjin Universitar "Qiriazi".pdf</i></p> | | | | | | |
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit | <p>Nga vlerësimi i faqes ëcb, konstatohet se nuk paraqiten kriteret për pranimin e studentëve aplikantë në programin e studimit master MPAB. Në linkun e programeve master listohen kriteret e programit bachelor. GVJ rekomandon përmirësimin e faqes në drejtim të paraqitjes së kriterëve dhe plotësimit të informacionit si dhe një praktikë të ndërthurjes të të gjitha instrumentave të komunikimit të publikut të gjerë në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> <p><i>Ref. www.qiriazi.edu.al</i></p> | | | | | | |
| Sbkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="564 1256 743 1346">Përmishet pjesërisht</th> <th data-bbox="743 1256 970 1346">Përmishet kryesisht</th> <th data-bbox="970 1256 1195 1346">Përmishet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="564 1346 743 1384"></td> <td data-bbox="743 1346 970 1384" style="text-align: center;">✓</td> <td data-bbox="970 1346 1195 1384"></td> </tr> </tbody> </table> | Përmishet pjesërisht | Përmishet kryesisht | Përmishet plotësisht | | ✓ | |
| Përmishet pjesërisht | Përmishet kryesisht | Përmishet plotësisht | | | | | |
| | ✓ | | | | | | |

| | |
|--|---|
| Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | <p>Departamenti i Menaxhim Biznesi, Zyra e Karrierës dhe sekretaria mësimore vënë në dispozicion informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregullorja e KUQ, rregullorja e FE, rregullorja e sekretarisë mësimore dhe rregullorja e programit të studimit. Rekomandohet publikimi i tyre edhe në ëcb. Nga vlerësimi i faqes ëcb, nuk paraqiten kriteret për pranimin e në programin e studimit master, edhe në link për programet master listohen kriteret e programit bachelor.</p> |

| | | | | |
|--|--|--------------------------------|-------------------------------|--------------------------------|
| | <i>Ref. www.giriaz.edu.al</i> | | | |
| Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Ky kriter plotësohet. Kriteret e ekuivalentimit janë të paraqitura në rregulloren e KUQ, konkretisht: një modul njihet si i vlefshëm (ekuivalentohet) kur është i ngjashëm në masën mbi 80% me atë të modulit në përbërje të programit të studimit që zhvillohet në njësinë bazë të kolegjit. Bazuar në numrin e krediteve të ekuivalentuara, përcaktohet dhe viti universitar se ku do të regjistrohet studenti, si dhe kreditet e debitet që ai duhet të plotësojë. <i>Anex. II. 1. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>Anex. III. 2. 2 Programi i studimit MP AB 2016-2018.pdf</i> <i>Anex. I. 3. Rregullora e KUQ</i> | | | |
| Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Ky kriter plotësohet. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit i bëhen të ditura studentëve dhe parashikohen në rregulloren mësimore të programit të studimit. Ato janë pjesë e silabuseve të lëndëve. <i>Anex. I. 3. Rregullora e KUQ, Neni 99</i> <i>Anex. III. 2. 4 Syllabus MP AB.pdf</i> <i>Anex. II. 5. Rregullore e Departamentit MB, Kren 5, Neni 70</i> | | | |
| Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës, për programin e studimit MP AB. Në përfundim të programit të studimit MP AB studenti mbron diplomën me provim përfundimtar ose diplomë. Në procedurën e diplomimit paraqitur në nenin 83-84-85 (<i>Anex. I. 3. Rregullore e KUQ</i>), GVJ sugjeron që procedura e diplomimit të plotësohet me praktika të vlerësimit për të rritur transparencën dhe cilësinë në këtë proces. Kështu pajisja me formularët e vlerësimit si temës të bazuar në disa kriteret të caktuara (si psh, cilësia e argumentit të përdorur, qasja kërkimore dhe instrumentat metodologjike të përdorur, respektimi rregullave të referimit dhe anti -plagjiatura etj) të bazuara në oponent dhe udhëheqës. <i>Anex. II. 1. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf, neni 36</i> <i>Anex. III. 1. Rregullore e MP Administrim Bëznesi.pdf, neni 15</i> | | | |
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | Institucioni ofron informacion në mënyrë të vazhdueshme nga të gjitha zyrat që lidhen direkt dhe indirekt me studentin. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmblotshëm | Përmblotshëm pjesërisht | Përmblotshëm kryesisht | Përmblotshëm plotësisht |
| | | | ✓ | |

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Departamenti i Menaxhim Biznesi informon studentët në lidhje me strukturën e organizimit të programit. Instrumentat e komunikimit janë fletpalosjet, broshura si dhe mjete të tjera komunikimi që KUQ disponon si: e-mail, Facebook, Instagram. Po kështu studentëve u vihet në dispozicion edhe nr. kontakti, e-mail edhe informacione të marra nga njësitë përgjegjëse si: sekretaria, zyra e karrierës dhe departamenti.</p> <p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese nëpërmjet platformës E-learning por edhe zyrave përgjegjëse.</p> <p><i>Anex 1.11.1_Fletpalosje Kolegjit Universitar "Qiriazi".pdf</i></p> <p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij në dokumentat e paraqitur më poshtë.</p> <p><i>Anex III.1_Rregullore e Program Studimi FE_MP_AB</i></p> <p><i>Anex 1.18_Sistemi Informatik dhe Metodat e Mësimdhënies.pdf</i></p> <p>Megjithatë GVJ rekomandon që informacioni në lidhje me modulet, lëndët, përmbajtjen dhe kreditet duhet të bëhet i aksesueshëm edhe në faqen ueb për të informuar edhe studentët jashtë KUQ duke përmbushur kështu një detyrim ligjor.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p> | <p>Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës, një praktikë e tillë vihet re dhe në ueb-in e institucionit ku janë publikuar oferta punësimi edhe për studentët. Nga takimi i GVJ zhvilluar në institucion me studentët, u evidentua që studentët pjesëmarrës në takim ishin të punësuar në pozicione që mbulohen nga ky program studimi.</p> |
| <p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p> | <p>Ky kriter plotësohet. Studentët komunikojnë me pedagogun nëpërmjet portalit e-learning për leksionet, detyrat e shtëpisë, detyrat kursit dhe për probleme të tjera që lidhen me modulin. Ky sistem i mundëson studentit të marrë informacion të nevojshëm edhe në distancë, çdo student mund të logohet nëpërmjet e-mail dhe kredencialeve të tjera që parashikon institucioni.</p> <p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve nëpërmjet zyrës së njësisë së sigurimit të cilësisë-sekretarise-arkivës dhe zyrës së burimeve njerëzore.</p> <p>Këto zyra janë në zhvillim e sipër dhe nga takimi i GVJ me GVB u konstatua kjo gjë. Si në drejtim të përmirësimit të proceseve të mbajtjes së rekordeve ashtu dhe në atë të ndarjes së detyrave.</p> |

| Shkalla e përbushjes së standardit | Përbushet plotësisht | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
|------------------------------------|----------------------|----------------------|---------------------|----------------------|
| | | | ✓ | |

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm


| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> | <p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë MP AB.</p> <p>Këto të dhëna ruhen nga sekretaria mësimore në CD dhe DVD dhe në regjistra me të dhëna standarte të miratuara nga MASR.</p> <p><i>(Aneks II-1-14).</i></p> <p>Numri i studentëve të regjistruar, për vitin akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2017-2018 3 studentë, - 2018-2019 1 student. <p>GVJ gjykon që numri i reduktuar i studentëve është një pikë e dobët për procesin e mësimdhënies dhe nxënies sepse pjesëmarrja dhe përfshirja në detyra praktike kërkon një numër të caktuar studentësh. Ky aspekt u përmend edhe në takimin e zhvilluar me studentët. GVJ rekomandon që në raste të tilla institucioni duhet të pajiset me një praktikë ku të përshkruhet, frekuenca si dhe qasja e përdorur në mësimdhënie dhe mësimnxënie për grupe shumë të vogla (më pak se 5).</p> <p>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi (mesataren në hyrje), deri në diplomimin e tyre.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konsultoi rregjistrat themelor ku çdo student është rregjistruar dhe ishte pajisur me numer matrikullimi.</p> <p>Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të rregjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e Bsc, listë notash etj.</p> <p>Dosja e studentëve ishte e pajisur me dokumentat si vijon: kontrata me administratorin, deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, diploma e shkollës së mesme, diploma e studimeve të ciklit të parë dhe lista e notave.</p> <p><i>Anex. 1.9 Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në</p> | <p>Institucioni harton raporte analitike periodike mbi profilit e studentëve, megjithatë në këto raporte duhet të paraqitet për çdo student të MPAB si nota mesatare në hyrje dhe ajo në dalje. Kjo i mundëson institucionit monitorimin me qëllim përmirësimin e</p> |

| | | | |
|---|---|-----------------------------|------------------------------|
| drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | cilësisë. Gjithashtu GVJ sugjeron që në funksion të këtij procesi të hartohen në të ardhmen raporte analitike mbi cilësinë në dalje dhe shkallën e punësimit. Kjo praktikë mund të zhvillohet duke koordinuar të gjitha zyrat në funksion të studentit si para dhe pas diplomimit (Alumni). | | |
| | <i>Anex_1_15_Raportet_vjetore_të_KUQ</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | ✓ | |

| Standardi V.5 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Studentët përfaqësohen në organet drejtuese të institucionit. Ndër strukturat kryesore përmendim: |
| Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | <ul style="list-style-type: none"> ▫ Senati Akademik ▫ Këshilli Etikës ▫ NJSBC <p><i>Anex_1_5_1_Rregullore_e_NJSBC-se.pdf, neni 5</i> <i>Anex_1_6_Rregullore_e_Keshillit_te_Etikes.pdf, neni 4</i></p> <p>Referuar RVB, në përbërje të GVB rezultojnë të ketë përfaqësues nga studentët e programit. Përfaqësuesi i studentëve ka siguruar të dhënat lidhur me studentët e programit. Gjithashtu një nga mekanizmat kryesor që NJSBC përdor, është anketa me studentët çdo fund semestri.</p> <p>Pavarësisht kësaj, GVJ nuk siguroi informacion për vendimmarrje të iniciuar nga studentët në lidhje me programin e studimit dhe cila është praktika e përfshirjes së tyre në procese të ndryshme që lidhen me sigurimin e cilësisë.</p> |
| Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesës së shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra. Në programin MP AB, në semestrin e parë studentët ndjekin 5 lëndë, ndërsa në semestrin e dytë 4 lëndë. <i>Anex_III_2_2_Programi_i_studimit_MP_AB_2016-2018.pdf</i> |
| Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe | Studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre. |

| <p>përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p> <p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultati, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p> | <p>Për ekzistencën dhe funksionimin e këtyre procedurave, studentët kanë informacion dhe i shfrytëzojnë këto të drejta.</p> <p>Megjithatë, GVJ nuk siguroi informacion për vendimmarrje të iniciuar nga studentët në lidhje me programin e studimit.</p> <p>GVJ vlerëson përfshirjen e studentëve në anketat e zhvilluar për vlerësimin e procesit mësimor megjithatë rekomandohet që krahas zhvillimit të pyetësorit për të analizuar cilësinë e pedagogëve të përdorur edhe instrumenta të tjerë në funksion të përmirësimit të programit. Psh, zhvillimi i fokus grupeve, pyetësorëve online dhe mbledhjeve të hapura të departamenteve. Këto mund të shërbejnë si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në raport me programin e studimit në tërësi dhe përmirësimin e tij në vazhdimësi. Gjithashtu përfshirja e bordeve të punës në mbledhjet e departamentit është një tjetër praktikë që mund të ndiqet në funksion të rritjes së cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>[Aneksi/Shënoje Sondazhi i studentëve, formulari i plotësuar konkretisht]</i></p> | | | | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|---|--|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="593 833 769 925">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="775 833 992 925">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="999 833 1216 925">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="593 934 769 936"></td> <td data-bbox="775 934 992 936" style="text-align: center;">✓</td> <td data-bbox="999 934 1216 936"></td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | ✓ | |
| Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | ✓ | | | | | | |

| <p>Standardi V.6</p> | |
|--|--|
| <p>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se KUQ, ka në strukturën e tij organizative Zyrën e Karrierës.</p> <p>Zyra e Karrierës e mbështet aktivitetin e vetë në rregulloren saj</p> <p>Nga takimi me studentë të PS MPAB dhe me përfaqësues të zyrës së karrierës, rezulton se kjo strukturë ofron informim dhe këshillim për studentët dhe asistimin e tyre për problematika të ndryshme, por GVJ është e mendimit që kjo strukturë duhet të zhvillojë dhe zbatojë një sistem të posaçëm në shërbim të studentëve dhe të dokumentojë funksionimin e këtij sistemi.</p> <p><i>[Organigrama e KUQ. Anex 1.8 Rregullore e zyrës së karrierës]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën</p> | <p>Në lidhje me këshillimin e karrierës, GVJ është e mendimit se zyra e karrierës duhet të planifikojë dhe të organizojë në mënyrë të vazhdueshme aktivitete informuese dhe orientuese në lidhje me punësimin e tyre të ardhshëm. Rekomandohet një kombinim më i përshtatshëm midis aktivitetit të zyrave administrative dhe sistemit të këshillimit në bazë të secilit departament. Kjo do të mundësojë ngritjen e një sistemi të përshtatshëm të informimit, këshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët.</p> <p>GVJ gjithashtu, nuk hasi në një dokumentacion që dëshmon se zyra e karrierës ndjek studentët pas diplomimit. Përsa më sipër GVJ sugjeron që institucioni të krijojë rrjetin ALUMNI dhe zyra</p> |



| | | | | |
|--|---|----------------------------|-----------------------------|--|
| dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse | e karrierës në lidhje me të dhënat që siguron për ecurinë e karrierës së tyre t'i vendosë në dispozicion të studentëve dhe organeve drejtuese të KUQ. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbyhet pjesërisht | Përmbyhet kryesisht | Përmbyhet plotësisht | |
| | | ✓ | | |

| | | | | |
|---|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|--|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Përmbyhet pjesërisht | Përmbyhet kryesisht | Përmbyhet plotësisht | |
| | | ✓ | | |

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

| | |
|--|---|
| Standardi VI.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjste përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p> | <p>Kolegji Universitar Qiriazi ka paraqitur parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në manualin e cilësisë, në përputhje me perspektivat e përgjithshme të përcaktuara nga Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (Shqipëri), duke respektuar kërkesat e përcaktuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, në Statutin e Kolegjit Universitar "Qiriazi" (2017), Planin Strategjik të Menaxhimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi" (KUQ) 2016-2025 dhe në aktet e tjera ligjore.</p> <p>Ky Manual hartohet dhe përditësohet rregullisht nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional që është pjesë e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional të KUQ-së. Të gjitha ndryshimet apo përditësimet i paraqiten Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor të Kolegjit dhe miratohen nga Senati Akademik.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të cilësisë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - monitorimin e cilësisë së menaxhimit akademik të Kolegjit dhe anëtarëve të tij; - pjesëmarrjen e studentëve dhe punonjësve në procedurat e vlerësimit të kryera nga KUQ; - përgatitjen e raporteve vjetore për vlerësimin institucional të sigurimit të cilësisë për strukturat universitare; - bashkëpunimin dhe menaxhimin e vlerësimeve ndërkombëtare |

| | |
|--|--|
| | <p>të programeve dhe akreditimeve programore të Kolegjit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - bashkëpunim me ASCAL dhe zbatimin e vendimeve të saj; - monitorimin e tendencave evropiane, sfidat dhe perspektivat e sigurimit të cilësisë: zbatimin e Planit Strategjik të ENQA, aktivitetet e grupit të ekspertëve shqiptarë për zbatimin e Marrëveshjes së Bolonjës (BFUG) dhe vendimet e Konferencës Ministrore të Bolonjës (2012), çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit të lartë evropian; (faqja 9, manuali i cilësisë). <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore (manuali i cilësisë).</p> <p>Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori me studentët (<i>Aneks II-12 – Pyetësori për studentët</i>) për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi.</p> <p>Për hartimin e këtij pyetësori angazhohet Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Anketa është e thjeshtë, dhe ka për qëllim të mbledhë opinionet e studentëve lidhur me procesin e mësimin dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me të. Pasi përpunohen të dhënat dhe nxirret rezultati, grupi i posaçëm i punës përgatit një raport, të cilin e vendos në dispozicion të departamenteve përkatëse.</p> <p>Nga konsultimi i e këtij pyetësori nga GVJ, u konstatua që vlerësimi i studentit bëhej në 5 fusha që lidhen me cilësinë e mësimdhënies, materialeve vizuale të ofruara, përfshirjen e studentëve në procesin e mësimor, korrektesën e pedagogut dhe etikën në sjellje. Nëpërmjet këtij pyetësori arrihet të mblidhen perceptimet e studentëve për cilësinë e pedagogëve. Megjithatë GVJ sugjeron që pyetësori të zhvillohet i veçantë për çdo modul dhe pedagog. Aktualisht ky pyetësor zhvillohet në mënyrë të përmbledhur për të gjithë pedagogët dhe modulet. Krahasimi i pedagogëve nga ana e studentit mund të deformojë perceptimet e tyre.</p> <p>Po kështu nga konsultimi i pyetësorit për matjen e performancës së pedagogut (<i>Aneks I-7-6, pyetësor performanca e pedagogut</i>) konstatohet që mënyra se si ky pyetësor është hartuar vështirëson matjen e performancës. Së pari fushat që do të vlerësohen dhe indikatorët përkatës nuk janë të qarta për të arritur në rezultate të përdorshme në lidhje me performancën e stafit akademik ose jo akademik.</p> <p>(<i>Aneks 1-5-2 Politikat e vlerësimit të brendshëm Aneks 1-5 Manuali i cilësisë, Aneks 1-5-1 – Rregullore e NjSBC,)</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në</p> | <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të licencimit, të akreditimit,</p> |

| | | | | |
|---|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato ofrojnë i nënshtrohen vlerësimit të parë, vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | ✓ | | |

Standardi VL2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | |
|--|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p> <p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p> | <p>KUQ ka ngritur Zyren për Sigurimit të Cilësisë që në bashkëpunim me Dëkanatin, Departamentet, monitorojnë, shqyrtojnë dhe, mbikëqyrin programet e ciklit të parë të studimeve. Ato bëjnë rishikimin e këtyre programeve.</p> <p>Pranë Senatit të KUQ, është ngritur dhe funksionon Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, i cili i raporton Senatit mbi vlerësimin dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit parë, duke garantuar cilësinë e tyre.</p> <p>Megjithatë, KUQ nuk ka paraqitur një praktikë të vlerësimit sasior dhe cilësor të programit të studimit.</p> <p>GVJ rekomandon që: veprimtarinë e saj NJSBC-ja mund ta zhvillojë sipas një plani kalendarik të përvitshëm, në të cilin programon monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.</p> <p>Në mënyrë periodike NJSBC-ja mund të informojë drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e KUQ rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit dhe njësive të tij bazë (procesverbalet e mbajtura në njësitë e ndryshme në lidhje me rezultatet e monitorimit mund të përbëjnë një praktikë të përdorshme për këtë qëllim.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | ✓ | | |

Standardi VL3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|----------|------------------------|
|----------|------------------------|

| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p> | <p>KUQ ofron një grup informacioni rreth praktikave që ndiqen në institucion për kontrollin periodik të programit të studimit, duke filluar nga rregulloret e NJSBC, raportet vjetore të KUQ, Politikat e vlerësimit të brendshëm etj. Raporti vjetor i vlerësimit në nivel departamenti nuk ishte midis dokumenteve të dorëzuara nga KUQ.</p> <p>Megjithëse dokumentet ishin të disponueshëm, në to mungonte metodologjia e vlerësimit, indikatorët të cilët mundësojnë vlerësimin në afatin e gjatë të ecures së programit të studimit, analiza mbi këta indikatorë si edhe masat e marra nga institucioni për të përmirësuar elementët negativë si edhe për të përhapur praktikën pozitive.</p> <p><u>Anex 1.5.1. Rregulloret e NJSBC-se.pdf</u></p> |
| <p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p> | <p>Në dokumentet e bashkëngjitura me RVB, mungon një metodologji për të mundësuar një vlerësim të koherent të programit të studimit bazuar në instrumente dhe indikatorë. Raportet e paraqitura nuk përmbajnë një analizë të vlerësimit të programit të studimit por kufizohet në të dhëna përshkruese të numrit të studentëve, të tarifave të studimit dhe mesataret e studentëve që studiojnë në programin e studimit pa sqaruar problemet e identifikuara si dhe praktikën pozitive. KUQ duhet të ndërtojte një metodologji e cila duhet të përfshinte grumbullimin e informacionit, analizimin e tij nëpërmjet indikatorëve, identifikimin e problemeve, marrjen e masave për zgjidhjen e problemeve, dhe kontrollin e vazhdueshëm të ecures së tyre.</p> <p>Në vlerësimin GVJ në mënyrë se si janë ndërtuar këto dokumente nuk ofrojnë një metodologji e cila mundëson një vlerësim të plotë të cilësisë së programit të studimit dhe kjo duhet të përmirësohet nga KUQ.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, teste lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në teste ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> | <p>KUQ thekson se “ka ngritur Zyrën për Sigurimin të Cilësisë që në bashkëpunim me Dekanatin, Departamentet, monitorojnë, shqyrtojnë dhe, mbikëqyrin programet e ciklit të parë të studimeve. Ato bëjnë rishikimin e këtyre programeve. Pranë Senatit të KUQ, është ngritur dhe funksionon Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, i cili i raporton Senatit mbi vlerësimin dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë, duke garantuar cilësinë e tyre”. Në asnjë prej dokumenteve mbështetëse të ofruara nga institucioni nuk ofrohet informacion rreth praktikës së ndjekur për të kryer këto procedura si edhe dokumentet, formatet që përdoren për të kryer këto proces. Institucioni nuk ofron gjithashtu një dokument i cili dëshmon raste kur janë ndërmarrë procedurat e mësipërme.</p> <p>GVJ nuk mund të vërtetojë se cilat prej procedurave të mësipërme kryhen nga institucioni, metodologjinë që përdoret për to, periodicitetin e kryerjes etj.</p> <p>Në funksion të garantimit të cilësisë, një rol të rëndësishëm përveç NJSBC-së kanë dhe departamentet si njësi përgjegjëse për</p> |

| | <p>programin e studimit, ku përgjegjësit e grup-lëndëve/ kordinatorët e programeve luajnë një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim. Bordet e tregut të punës kanë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm pasi reflektojnë dinamikat dhe kërkesat që vijnë nga tregu. GVJ sugjeron që rekomandimet e aktorëve të përmendur më sipër bëhen bazë për ndryshime në PS në funksion të përshtatjes sa më mirë me këto kërkesa.</p> | | | | | | | | |
|---|---|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|---|--|--|
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p> | <p>KUQ aplikon një sondazh me studentët për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, pyetësori i cili zhvillohet në fund të vitit akademik në mënyrë të përgjithshme për të gjithë lëndët por jo në mënyrë të veçantë për secilin prej moduleve. Kjo praktikë e ndjekur pengon identifikimin e problematikave specifike për secilin modul.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ vë re që nuk ka një praktikë në të cilën të përshkruhet procesi i zbatimit të saj, mënyrës së përpunimit të informacionit dhe masave të ndërmarra për përmirësimin e situatës apo përhapjen e praktikave pozitive brenda institucionit.</p> <p>KUQ nuk ka vënë në dispozicion procedura të anketimit të stafit akademik dhe ndihmës akademik si edhe përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit nëpërmjet grumbullimit të informacionit nga ish studentët, bashkëpunëtorët e programit të studimit etj.</p> <p>GVJ gjykon që institucioni duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim për të krijuar një bazë të gjerë e periodike informacioni si edhe mënyra të krahasueshme të përpunimit të informacionit me qëllim krahasueshmërinë e tij nga një vit në tjetrin.</p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | ✓ | | |
| | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | ✓ | | | | | | | | |

| <p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p> | |
|--|---|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>KUQ parashikon përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe studentëve në sigurimin e cilësisë (<i>statuti i KUQ neni 43</i>) si edhe e detyrave të NJSBC në tërësinë e tyre, por mungon një dokument i cili specifikon procedurat që duhet të ndërmarrë kjo njësi si dhe përgjegjësitë e secilit prej anëtarëve të njësisë.</p> <p>KUQ specifikon se “Zyra NJSBC përbëhet nga drejtuesit e zyrës, tre anëtarë të personelit akademik dhe një përfaqësues i studentëve”, por nuk specifikon në mënyrë të qartë detyrat specifike për njësinë në tërësi por edhe për anëtarët e saj në mënyrë specifike.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për</p> | <p>Institucioni thekson se në formimin e NJSBC janë përfshirë personel akademik, ndihmës akademik edhe nga njësi bazë ka</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>njësitet, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> | <p>paraqitur listën e pjestarëve në këtë njësi.</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Institucioni thekson se në formimin e NJSBC janë përfshirë personel akademik, ndihmës akademik edhe nga njësia bazë ka paraqitur listën e pjestarëve në këtë njësi.</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p> | <p>Kriteri plotësohet, RVB disponon një listë të pjesëtarëve të NJSBC.</p> <p>GVJ nuk disponon një listë të pjesëtarëve të jashtëm në NJSBC për të vlerësuar këtë kriter dhe sugjeron që në të ardhmen të përfshihen edhe anëtarë nga bordet e punës (studentë të punësuar si nga ciklet e para të studimit ashtu edhe ato të cikleve të dyta).</p> <p>Në përzgjedhjen e anëtarëve mund të merren parasysh kriteret e mëposhtme:</p> <p>a) Kompetencat profesionale;</p> <p>b) Paanshmëria;</p> <p>c) Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe</p> <p>d) Shkalla e nevojshme e njohjes të anëtarëve të Komisionit;</p> <p>e) Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të KUQ</p> | | | |
| <p>Shtylla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Standardi VL5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> | <p>Raporti i vlerësimit të brendshëm liston një dokument te i cili GVJ mund të bazohet për të gjykuar për kriterin por ky dokument nuk është paraqitur. <i>Anex 1: Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë;</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> | <p>Raporti i vlerësimit të brendshëm liston një dokument te i cili GVJ mund të bazohet për të gjykuar për kriterin por ky dokument nuk është paraqitur.</p> <p><i>Aneks Politikat institucionale të publikimit të informacionit</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e</p> | <p>Për secilin nga proceset akademike që vlerësohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre NJSBC raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Njëherazi, rekomandon detyra, zbatimi i të cilave</p> |

| | |
|---|---|
| <p>mangësive e dobësive të evidentuara.</p> | <p>ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë NJSBC. Shpesh rekomandimet kanë qënë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit, në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Institucioni disponon rregulloren, manualin dhe politikat e vlerësimit të brendshëm. Kjo tregon që ka bërë përpjekje të rëndësishme në këtë fushë.</p> <p>Megjithatë informacioni do të ishte më i plotë nëse do të ishte ofruar nga IAL një praktikë vlerësimi të syllabusit, nëse ai psh është hartuar sipas formatit, ose praktikë e kontrollit të tezës, në lidhje me pikët, formatin etj.</p> <p>Ofrimi i informacioneve të këtij tipi do të ofronte një pamje më të qartë për praktikat, proceset, indikatorët, gjetjet dhe raportimi i tyre.</p> |
|---|---|

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p> | <p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të Kolegjit dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm vjetore.</p> <p>Këto raporte diskutohen në Rektorat e Bordin e Administrimit, u bëhen të njohura strukturave përgjegjëse të Institucionit dhe i dergohen MASR. Por GVJ duke iu referuar raporteve të depozituara në sistemin AMS është e mendimit që NJSBC duhet të hartojë raporte vjetore, në mënyrë të posaçme dhe të detajuar për gjithë aktivitetin e vet, mekanizmat e përdorur dhe identifikimin e praktikave të mira/problematikave dhe të propozojë/adresojë zgjidhje për to.</p> <p>Dokumentat e ofruara nuk të mundësojnë vlerësimin e një kriteri të tillë. GVJ rekomandon që një mënyrë e mirë për të përfshirë dhe ndërgjegjësuar studentët për cilësinë e programit dhe kontributin e tyre është duke i bërë pjesë të mbledhjeve të departamentit.</p> |
|---|--|

| | | | | |
|---|------------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | ✓ | |

| | | | | |
|---|------------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | ✓ | | |

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Administrim Biznesi." të IAL "Kolegji Universitar Qiriazi"

Pikat e forta dhe afirmime

- 1) Infrastruktura e plotë dhe cilësore që ofron institucioni për zhvillimin normal të programit të studimit.
- 2) Staf akademik i përkushtuar
- 3) Lokacioni dhe vendodhja në zonë të gjelbëruar
- 4) Eksperienca dhe kualifikimet e stafit akademik
- 5) Angazhimi i drejtuesve të lartë të institucionit, eksperienca dhe mundësitë që ata ofrojnë në funksion të kolegjit
- 6) Marrëveshjet e nënshkruara me institucione/organizata biznesi, ofrojnë mundësi për partnerite efektive në funksion të PS MPAB

Pika të dobëta

- 1) Programi i studimit ka mangësitë si më poshtë:
 - a. Në lëndët karakterizuese të programit, nuk ofron një lidhje direkte me titullin që ai lëshon
 - b. Mungesa në planin mësimor të lëndëve manaxheriale që do të zhvillonin kompetencat e duhura manaxheriale tek studentët, në përputhje me objektivat dhe rezultatet e pritshme që ky program deklaron;
 - c. Plani mësimor nuk është hartuar në përputhshmëri me bazën ligjore respektive
- 2) Mbivendosje të detyrave për stafin administrativ
- 3) Njësia bazë përgjegjëse për programin nuk plotëson kërkesat ligjore sasiore për minimumin e lejuar të stafit akademik prej 7 anëtarësh për periudhën 2 vjecare të akreditimit. Instiucioni e ka plotësuar këtë kusht në Maj 2019.
- 4) Mungesa e një sistemi informacioni të integruar në rang institucioni
- 5) Biblioteka ka nevojë të pasurohet:
 - a. me libra hard copy, revista shkencore dhe për një infrastrukturë më të përshtatshme
 - b. me akses në bibliotekë online
- 6) Mungesa e dokumentimit dhe e gjurmimit të procedurave të rekrutimit të stafit akademik;
- 7) Një pjesë e procedurave të performuara nga stafi administrativ nuk dokumentohen formalisht;
- 8) Numer i vogël i studentëve të rregjistruar në programin e studimit MPAB
- 9) Përfshirje e ulët e studentëve në projekte dhe konferenca shkencore;
- 10) Përfshirje e ulët e stafëve akademike në projekte kombëtare apo ndërkombëtare;
- 11) Në planin për mbështetjen financiare mungojnë aktivitetet e detajuara të planifikuara për mbarëvajtjen e PS MPAB për në cikël të plotë studimi;
- 12) GVJ konstaton se NJSBC:

- a. ka mungesë në dokumentimin e procedurave që zbaton;
- b. Raportet e NJSBC janë të përgjithshme, ato duhet të identifikojnë problemet specifike dhe ti adresojnë ato dhe të propozojnë zgjidhje;
- c. duhet të përmirësojë mekanizmat e përdorur për vlerësimin e cilësisë dhe duhet të përdorë mekanizma të diversifikuar vlerësimi;

Rekomandime/Sugjerime:

1. *Rekomandohet një studim tregu më i detajuar mbi të cilin është mbështetur hartimi i programit si dhe një analizë e praktikave më të mira ekzistuese (benchmarking) për të justifikuar programin ekzistues si dhe përmirësimet që janë zhvilluar për periudhën 2016-2019.*
2. *GVJ rekomandon rishikimin e objektivave dhe rezultateve të pritshme, për tu përshtatur më nivelin e masterit profesional si dhe rishikimin e planit mësimor duke integruar në të lëndë të si Manaxhim Operacionesh I avancuar, Burime njerezore të avancuara, etj, të cilat së pari do ti bënin objektivat të arritshme dhe së dyti do të forconin bërthamën e lëndëve karakterizuese të PS MPAB dhe rrisnin përputshmërinë me emertimin e diplomës që ky program master lëshon.*
3. *Rekomandohet një riorganizim i planit mësimor, në mënyrë të tillë që shpërndarja e lëndëve sipas kategorive formuese të të respektojë bazën ligjore, VKM 41.*
4. *Futja e lëndëve të mënaxhimit si Manaxhim Operacionesh i avancuar, Burime njerezore të avancuara, Sjellje Organizative, Sipërmarrja, Manaxhim Strategjik i avancuar, është një nevojë për të përshtatur programin e studimit me titullin e lëshuar.*
5. *Respektimi i dispozitave ligjore për formatin e silabusit, dhe për literaturën e përdorur.*
6. *Respektimi i dispozitave ligjore për raportin staf akademik efektiv/staf akademik me kontrate*
7. *Shmangie e mbivendosjes së detyrave për stafin administrative. Ndarje më të qartë të detyrave dhe një organizim më funksional*
8. *Biblioteka e institucionit duhet të azhurnohet me titujt e hotimeve të fundit, të shtojë numrin e kopjeve në bibliotekë si dhe të ketë një organizim më efektiv si dhe hapësira më komode e motivuese për studentët*
9. *Në lidhje me kontrollin e brendshëm të cilësisë, nevojiten përmirësime të mëtejshme sidomos në drejtim të hartimit të praktikave konkrete të kontrollit të cilësisë si edhe indikatorë për praktika të ndryshme (psh si çfarë kontrollohet në një tezë provimi, si kryhet kontrolli dhe si raportohen gjetjet, po kështu edhe me silabuset)*
10. *NJSBC duhet të hartojë raporte vjetore, në mënyrë të posacme dhe të detajuar për gjithë aktivitetin e vetë, mekanizmat e përdorur dhe identifikimin e praktikave të mira/problematikave dhe të propozojë/adresojë zgjidhje për to.*
11. *Në kuader NJSBC-së nevojiten përmirësime të mëtejshme sidomos në drejtim të hartimit të praktikave konkrete të kontrollit të cilësisë si edhe indikatorë për praktika të ndryshme (psh si çfarë kontrollohet në një tezë provimi, si kryhet kontrolli dhe si raportohen gjetjet, po kështu edhe me syllabuset)*
12. *Institucioni duhet të përmirësojë ndjeshëm dokumentimin formal të proceseve të realizuara për përmirësimin e cilësisë.*

13. *Ndjekja e politikave më proaktive të mbështetjes për përfshirjen e stafit në kërkimin shkencor, vendosjen e sistemeve motivuese e stimuluese të pjesëmarrjes në konferenca nderkombëtare prestigjioze, apo botimet në revista shkencore prestigjioze të fushës së ekonomisë*
14. *Sugjerohet që për secilën nga zyrat që shoqëron studentin nga hyrja në dalje, pra nga sekretaria mësimore deri te zyra e marrëdhënieve me jashtë, pranimeve dhe këshillimit të karrierës të dokumentojë aktivitetet.*
15. *GVJ sugjeron që procedura e diplomimit të plotësohet me praktika të vlerësimit për të rritur transparencën dhe cilësinë në këtë proces.*

CONCLUSIONS OF EVALUATION OF STUDY PROGRAM, PROFESSIONAL MASTER IN "BUSINESS ADMINISTRATION"

Strengths and affirmations

1. Quality infrastructure provided by the institution for the normal development of the study program.
2. Dedicated academic staff
3. Location is in the green area
4. Academic staff experience and qualifications
5. Engagement of senior management of the institution, experience and opportunities they offer in the function of the college
6. Agreements signed with business institutions / organizations, provide opportunities for effective partnerships in the function of SP MPBA

Weaknesses

- 1) The study program has the following disadvantages:
 - a. in basic subjects it does not provide a direct link to the title it issues
 - b. Lack of management subjects in this program study, that would develop appropriate managerial competencies for students, in line with the objectives and expected outcomes that this program states;
 - c. Curricula is not drafted in accordance with the respective legal basis;
- 2) The department responsible for the program does not meet the quantitative legal requirements for the permitted minimum of 7 member academic staff, for the 2-years accreditation period. The institution has fulfilled this requirement in May 2019.
- 3) Overlapping tasks for administrative staff
- 4) Lack of an institutionally integrated information system
- 5) The Library needs to be enriched:
 - a. with hard copy books, scientific journals and for a more convenient infrastructure;
 - b. with access to the online library

- 6) Lack of documentation and tracking of academic staff recruitment procedures;
- 7) Some of the procedures performed by administrative staff are not formally documented;
- 8) Small number of students enrolled in the MPAB study program
- 9) Low student involvement in scientific projects and conferences;
- 10) Low involvement of academic staff in national or international projects;
- 11) Detailed activities planned for the progress of the SP MPBA for a full study cycle, are missing in the plan for financial support;
- 12) The EET finds that the IQAU:
 - a. lacks documentation of the procedures it implements;
 - b. The IQAU reports are general, they should identify specific problems and address them and propose solutions;
 - c. improve the mechanisms used for quality assessment and use diversified assessment mechanisms;

Recommendations/ Suggestions:

- 1) *The external experts team recommends to the HEI to develop a detailed market study, which should serve as a guide on the program study development and or possible improvements. It is recommended to the HEI as well to develop a benchmarking study on the existing best practices, in order to justify the study program improvements done during 2016-2019.*
- 2) *The EET recommends reviewing the objectives and expected results to fit the professional master's level as well as revising the curriculum by integrating into it subjects such as Advanced Operations Management, Advanced Human Resources, etc., which will first to make the objectives attainable and secondly to strengthen the core of PS MPAB's characterization courses and increase compliance with the diploma designation that this master program issues.*
- 3) *A reorganization of the Curricula of MPAB is recommended, in such a way that the distribution of subjects by formative categories respects the legal basis, DCM 41.*
- 4) *Including management subjects such as Advanced Operations Management, Advanced Human Resources, Organizational Behaviour, Entrepreneurship, Advanced Strategic Management, is a need to adapt the study program to the title released.*
- 5) *It is recommended to adapt the format of the syllabi in line with the legislation in place.*
- 6) *It is recommended as well to improve ratio internal/external academic staff in line with the legislation in line*
- 7) *It is recommended to clarify and better define the administrative tasks in order to be performed more efficiently by the administrative staff.*
- 8) *It is recommended to update the library. The HEI should increase the number of books for each title, and improve the premises of the library to be more comfortable and attractive for the students.*
- 9) *The quality assurance unit, should draft, approve on the respective authorities and apply procedures on quality assurance, and include specific indicators for each procedure (e.g. what is a subject of a evaluation on an exam test, how the control is applied, who gathers the findings and who is responsible to apply the improvements, etc.)*

- 10) The quality assurance units should draft annual reports on the activities performed by them, the instruments used, identification of good practices problems verified, and propose measures to address them.
- 11) The HEI should improve considerably the forms of the existing quality assurance procedures.
- 12) The institution should significantly improve the formal documentation of quality improvement processes.
- 13) The HEI should follow proactive strategies in order to improve the staff scientific research by applying reward instruments for outstanding lecturers on scientific research.
- 14) All the administrative services for the students should be able to record and present their activity
- 15) The EAG suggests that the graduation procedure be complemented by assessment practices to increase transparency and quality in the process.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|--|--|--------------------------|-------------------------|--------------------------|
| | Përfundimisht | Përfundimisht pjesërisht | Përfundimisht kryesisht | Përfundimisht plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | ✓ | | |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | ✓ | | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | ✓ | |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | ✓ | | |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | ✓ | |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | ✓ | | |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | ✓ | | |

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Etleva Leskaj

PhD. Elena Kokthi